

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5802  
E shtunë, 15 qershor 2019  
çmimi 0.40 €

Thaçi: Pa kontributin e Shqipërisë, Kosova nuk do të ishte e lirë dhe e pavarur



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

**KUR ORA KTHEHET MBRAPSHTË, NGA NJERËZ TË MBRAPSHTË!**

F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**NË CILAT RASTE DHUNA SEKSUALE ËSHTË AKT I GJENOCIDIT**

F. 11



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

**KËNDVËSHTRIM FILOZOFIK-POLITIK MBI IDENË E LIRISË 20 VJET PAS ÇLIRIMIT TË KOSOVËS**

F. 11  
Prof. ass. dr. Sabri KIÇMARI



**MPB-ja, QYTETARËVE: NË STINËN E VERËS TË JENI VIGJILENTË NDAJ ZJARRVËNIEVE**

F. 10

## EKONOMI

**GUVERNATORI MEHMETI: KOSOVA KA STABILITET FINANCIAR**

F. 9

**FMN-ja, FAKTORE E RËNDËSISHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS**

F. 9

## SPORT

**STADIUMI KOMBËTAR, PROJEKTI MË I MADH KAPITAL NË HISTORINË E VENDIT**

F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERAND STAVILECI

FAQE 4-5

## Veseli është lider i pakontestueshëm i PDK-së

- Sondazhet profesionale dhe objektive kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka thënë se sondazhet e fundit profesionale dhe objektive kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka

e re", ai ka deklaruar se procesi i brendshëm zgjedhor ka rritur besimin e elektoratit ndaj kreut të kësaj partie. Sipas Stavilecit, Kadri Veseli është lider i pakontestueshëm i PDK-së. Në këtë kontekst, ai ka thënë se edhe para procesit zgjedhor edhe

gjatë procesit zgjedhor të gjitha degët dhe strukturat e reja drejtuese i kanë dhënë një mbështetje të fuqishme Veselit. Ai ka pohuar se PDK-ja do të jetë përsëri lokomotiva e proceseve më të rëndësishme për vendin edhe në dekadën e ardhshme

## GSJP-ja: Tribunali për krimet e luftës në Kosovë të mos shfrytëzohet për poenë politike

Themelimi i tribunalit ndërkombëtar për gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë duhet të bëhet larg agjendave politike dhe të mos shfrytëzohet për poenë politike. Kështu është thënë të premten nga të pranishmit në tryezën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP), ku është folur për Gjykatën Speciale dhe tribunalin ndërkombëtar. Sa i përket funksionimit të Gjykatës Speciale, është theksuar se kjo gjykatë do të tentojë ta paraqesë një pasqyrë të shtrembëruar të luftës së drejtë të UÇK-së



## Pjesëtarët e FSK-së dhe të policisë dhurojnë gjak

FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi e fton Trumpin në Beograd, i kërkon ndihmë për Kosovën

**BEOGRAD, 14 QERSHOR** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i uroi presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ditëlindjen dhe e ftoi ta vizitojë Serbinë. "Me vizitën tuaj do të konfirmohet se dëshira për lidhje më të forta dhe më të pasura serbo-amerikane është e dyanshme dhe qytetarët e Serbisë do të dinë ta respektojnë dhe vlerësojnë", ka shkruar Vuçiqi në urimin dërguar Trumpit, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë.

Vuçiqi, po ashtu, citohet të ketë thënë se është i inkurajuar nga


fakti se Trumpi u kushton vëmendje zhvillimeve në Ballkan dhe se disa herë ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës për normalizimin e marrëdhënieve. "Siç e dini edhe vetë, përmes problemit të Kosovës kryqëzohen të drejta dhe interesa jo vetëm të Beogradit dhe Prishtinës, por edhe të faktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë, me ç'gjë bëhet edhe burim i manipulimit dhe paqëndrueshmërisë politike", tha Vuçiqi. Ai shtoi se të gjithë qytetarët e

Serbisë e dinë se Shtetet e Bashkuara kanë një marrëdhënie të veçantë me Kosovën, duke e konsideruar atë si shtet të pavarur, të cilin e kanë mbështetur dhe ndihmuar gjithmonë. Vuçiqi tha se kjo është pikërisht arsyeja përse dëshiron ta lusë Trumpin që të ndikojë te Prishtina për ta hequr taksën që ua ka vënë prodhimeve të importuara nga Serbia. Kjo taksë, që ka nisur të aplikohet qysh në nëntor të vitit të kaluar, është bërë shkak për ndërprerjen e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë.



## Opozita paralajmëron protestën e radhës, Rama i vendosur t'i mbajë zgjedhjet

Në kohën që kreu i qeverisë ka vendosur të hyjë në zgjedhje pa opozitën, duke tentuar asgjësimin e saj, opozita ka rritur tonet e protestave dhe ka vendosur që protesta e madhe e radhës të zhvillohet më 21 qershor



**TIRANË, 14 QERSHOR** - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në takim me drejtuesit e PD-së ka deklaruar se vendi ndodhet në një nga situatat më emergjente. Kreu i PD-së u shpreh se kryeministri Edi Rama i ka shpallur luftë opozitës dhe çdo qytetari të këtij vendi. Duke theksuar se nuk mund të ketë zgjedhje pa opozitën, Basha e ka konsideruar krim procesin e 30 qershorit, veçanërisht në kushtet e dekretit të presidentit. "Duhet ta mbrojmë vendin dhe qytetarët, Kushtetutën. Jemi në të drejtën tonë t'i përgjigjemi me çdo çmim dhe me çdo mjet", është shprehur Basha.

Gjatë mbledhjes, Basha ka theksuar se strukturat e partisë janë

në punë të pandërprerë. "Takime me qytetarët për t'u shpjeguar se Rama po bën 'grusht shteti'. Është rrezik kombëtar, duhet ndalur menjëherë. Vendi rrezikon rikthimin e vizave, izolimin, regjim represiv përmes arrestimeve", ka thënë Basha. Opozita ka vendosur që protesta e madhe e radhës të zhvillohet më 21 qershor, në orën 20:00. Tubimi do të mbahet në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", para godinës së

Kryeministrit. Vendimi është marrë pas konsultimeve të Lulzim Bashës me aleatët dhe me forumet drejtues të PD-së.

Në kohën që kreu i qeverisë ka vendosur të hyjë në zgjedhje pa opozitën duke tentuar asgjësimin e saj, opozita ka rritur tonet e protestave. Protesta e 21 qershorit pritet të mos jetë si ato që kemi parë deri më sot.

Ndërkohë, kryeministri Edi Rama në një atmosferë të tensionuar në Ballsh, ku ka prezan-

tuar kandidatin për bashkinë, ka bërë një deklaratë që, edhe pse indirekte, la të kuptohej shumë për fatin e integritet të vendit në BE. "E kanë me negociatat për anëtarësim në BE. Nëse çelen negociatat, hapi i parë është hapja e dy kapitujve të parë të bisedimeve dhe janë kapitujt e drejtësisë. Dhe në kushtet që ne kemi ngritur institucionet e vettingut, nëse hapim negociatat, BE-ja nuk do të na kërkojë çka kemi në letër. Po, do të na thonë sa

është i gatshëm sistemi juaj i drejtësisë t'i hetojë dhe ndëshkojë ata që për 30 vjet kanë qenë të paprekshëm", tha shefi i qeverisë duke iu referuar atyre që duan, sipas tij, ta pengojnë reformën në drejtësi.

Deklarata shumë e fortë e Ramës la të nënkuptuar se do të ketë "kurban" për hapjen e negociatave dhe këtu përmendi politikanët e 30 vjetëve të shkuara, normalisht duke drejtuar gjatë nga ish-kryeministri Sali Berisha dhe presidenti Ilir Meta. Madje solli si shembull vendet që janë anëtarësuar në BE, duke thënë se kanë arrestuar ish-ministra, presidentë dhe ish-presidentë.

"Duhet ta shikoni ecurinë e vendeve që janë integruar në BE për të kuptuar si kanë dënuar ministra, ish-ministra, presidentë, ish-presidentë, sepse sistemi nuk varet nga politika dhe s'bën dallim kush është më i gjati, kush është më i shkurtri. Ndaj ju e dini shumë mirë se ç'i pret këta që janë organizator të kësaj gjullurdie, që prej muajsh mbyllin baskitë këtu, edhe ujęsjellësit dhe nisen për Tiranë e djegin atje shkrepësen te kazani i plehrave. Dhe pamja atje mbërrin në Evropë dhe përhapet atje ideja se çfarë negociatash duan këta ku është ngritur populli kundër një qeverie kriminelësh", tha Rama.

## Trumpi i shkruan presidentit Pendarovski

**SHKUP, 14 QERSHOR** - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, në një letër urimi drejtuar presidentit Pendarovski shkruan se "sot dy kombet janë më afër se kurrë më parë". "Shtetet e Bashkuara mbështesin fuqimisht Maqedoninë e Veriut, e cila mori vendin e saj të duhur në institucionet perëndimore dhe

veçanërisht shpreson ta mirëpresë Maqedoninë e Veriut së shpejti si aleati ynë i 30-të i NATO-s. Marrëveshja historike e Prespës është një shembull i guximshëm që përforcon siguri dhe prosperitet për popullin e Maqedonisë së Veriut dhe të gjithë rajonin. Angazhimi i vendit tuaj ndaj

parimeve demokratike, sundimit të ligjit, llogaridhënies së qeverisë dhe luftës kundër korrupsionit janë përshëndetur. Shpresoj në thellimin e miqësisë dhe bashkëpunimin në të ardhmen", shkruan presidenti Trump në letërën e urimit për presidentin e Maqedonisë Veriore, Pendarovski.



Mbahet tryeza lidhur me funksionimin e Gjykatës Speciale dhe themelimin e tribunalit ndërkombëtar

## GSJP-ja: Tribunali për krimet e luftës në Kosovë të mos shfrytëzohet për poenë politike

Themelimi i tribunalit ndërkombëtar për gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë duhet të bëhet larg agjendave politike dhe të mos shfrytëzohet për poenë politike. Kështu është thënë të premten nga të pranishmit në tryezën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP), ku është folur për Gjykatën Speciale dhe tribunalin ndërkombëtar. Sa i përket funksionimit të Gjykatës Speciale është theksuar se kjo gjykatë do të tentojë ta paraqesë një pasqyrë të shtrembëruar të luftës së drejtë të UÇK-së

duhet të bëhet larg agjendave politike dhe të mos shfrytëzohet për poenë politike. Sipas saj, duhet të kenë një qasje serioze dhe të themelohet një komision shtetëror profesional i cili do të hartonte një kornizë për procesin e gjyqimeve të krimeve të luftës në Kosovë. "Konsiderojmë se është me rëndësi që ky proces t'i përmbajë tri faza në mënyrë që të jetë kredibil. Së pari të realizohet me sukses faza e dokumentimit të krimeve, pastaj faza e hetimit dhe faza e gjyqimit", ka theksuar Loxha, duke shtuar se legjislacioni aktual në Kosovë mundëson gjykimin e krimeve të luftës. Ajo ka thënë se barra për dështimin e mosgjyqimit të krimeve të luftës në Kosovë bie mbi prokurorin e shtetit, misionin e UNMIK-ut, EULEX-it dhe aktorëve të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ndërsa deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes

Vetëvendosje (LV), Albulena Haxhiu, ka paraqitur qëndrimin e kësaj partie në raport me Gjykatën Speciale, kundërshkrimin dhe argumentimin politik dhe juridik të asaj kohe. Kurse sa i përket propozimit për tribunalin ndërkombëtar, ajo ka thënë se është mashtrim dhe se Kosova nuk ka kompetenca për krijimin e tij. "Mënyra se si është krijuar Gjykata Speciale që në fillim ka treguar se është një eksperiment për Republikën e Kosovës. Prandaj kemi konsideruar se kjo gjykatë do të tentojë ta paraqesë një pasqyrë të shtrembëruar të luftës së drejtë të UÇK-së. Është koha e fundit kur ne duhet t'i trajtojmë seriozisht krimet e luftës dhe askush nuk mund ta bëjë këtë më mirë se ne. Propozimi për tribunalin ndërkombëtar është mashtrim dhe se Kosova nuk ka kompetenca për krijimin e tij dhe se me krimet e luftës duhet

të merremi seriozisht si shtet, përmes mekanizmave të specializuar vendorë", ka theksuar ajo. Haxhiu ka përshëndetur kalimin e ndryshimeve për gjykimin në mungesë për krimet e luftës si një ndryshim i vonuar por, megjithatë, i domosdoshëm. Kurse profesori i së Drejtës Penale, Avni Puka, ka thënë se Gjykata Speciale është sukses i Serbisë, ndërsa tribunalin për krimet serbe është i mundur, por jo në këtë kohë. "Gjykata Speciale është sukses i Serbisë, i asaj që ka bërë ndër vite me një raport të Dick Martit, që realisht nuk përmban prova, prandaj kemi këto probleme të gjykatave speciale. Paralel me një sukses të shtetit serb, është një dështim i shtetit të Kosovës. Nuk është e lehtë për të ndërtuar një mekanizëm për t'i adresuar krimet e luftës, pa marrë parasysh se ne jemi vonuar 20 vjet. Tribunalin për krimet serbe është i mundur, por jo në këtë kohë", ka theksuar Puka. Ndërsa Artan Qerkini ka bërë me dije se në dhomat e specializuara ndiqet një procedurë jo shumë e zakonshme. "Kodi i procedurës penale nuk aplikohet pranë dhomave të specializuara, por aplikohen rregullat e procedurës, të cilat janë nxjerrë nga vetë gjyqtarët e Gjykatës Speciale ngaqë një gjë e tillë parashikohet me ligj. Fillimisht duke ushtruar profesionin e avokatit pranë këtyre dhomave, jam ballafaquar me një urdhër të zyrës së prokurorit të specializuar i cili, për mendimin tim, binte ndesh me Kushtetutën e Kosovës, sepse ai cenonte garantitë elementare procedurale të të dyshuarit në procedurën penale", ka deklaruar Qerkini, duke shtuar se tribunalin ndërkombëtar mund të themelohet nëse ka vullnet nga bashkësia ndërkombëtare.

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) të premten ka mbajtur tryezën me temë "Gjykata Speciale në veprim: një analizë e zhvillimeve kyçe lidhur me funksionimin e dhomave të specializuara dhe punës së zyrës së

prokurorit të specializuar", ku të pranishmit kanë diskutuar për Gjykatën Speciale dhe tribunalin ndërkombëtar për gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë. Drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GSJP), Arbëresha Loxha, ka deklaruar se themelimi i tribunalit ndërkombëtar



## Pjesëtarët e FSK-së dhe të policisë dhurojnë gjak

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Në Sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë të premten është shënuar 14 Qershori, Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut. Aktivitetit të dhurimit të gjakut iu bashkuan edhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) dhe Policisë së Kosovës. Me këtë rast, shefi i Departamentit të Planifikimeve, kolonel Sefer Isufi, para mediave dhe të pranishmeve, duke u bazuar në misionin dhe detyrat e institucionit të FSK-së, ka shprehur gatishmërinë e pjesë-

tarëve të FSK-së në mbështetje të qytetarëve të vendit. "Pjesëtarët e FSK-së janë të përkushtuar për ofrimin e mundësive të tyre fizike dhe profesionale, për përmbushjen e misionit të tyre të shenjtë në mbështetje të qytetarëve. Edhe ky aksion, të cilit sot i jemi bashkuar rreth 60 pjesëtarë, është në vazhden e mbështetjes së institucioneve tona dhe qytetarëve të vendit", ka thënë Isufi. Ndërsa drejtoresha e QKKTGj-së, dr. Bukurije Zhubi, ka vlerësuar lart interesimin e shumë

qytetarëve, sidomos të pjesëtarëve të dy institucioneve të sigurisë, FSK-së dhe Policisë së Kosovës, të cilët çdoherë u janë përgjigjur pa hezitim kërkesave për dhurimin e gjakut. Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut shënohet çdo vit në Kosovë. Këtë vit zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë e kanë organizuar këtë aktivitet me qëllim të vetëdijesimit dhe sensibilizimit të popullatës për të dhuruar gjak dhe për t'i shpëtuar jetët e të gjithë atyre që kanë nevojë.



Flet për "Epokën e re", Blerand Stavileci

# Veseli është lider i pakos

**- Sondazhet profesionale dhe objektive kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë**



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka thënë se sondazhet e fundit profesionale dhe objektive kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se procesi i brendshëm zgjedhor ka rritur besimin e elektoratit ndaj kreut të kësaj partie. Sipas Stavilecit, Kadri Veseli është lider i pakontestueshëm i PDK-së. Në këtë kontekst, ai ka thënë se edhe para procesit zgjedhor edhe gjatë procesit zgjedhor të gjitha degët dhe strukturat e reja drejtuese i kanë dhënë një mbështetje të fuqishme Veselit. Ai ka pohuar se PDK-ja do të jetë përsëri lokomotiva e proceseve më të rëndësishme për vendin edhe në dekadën e ardhshme

vend. "Sondazhet e fundit, profesionale dhe objektive, kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë. Ndërkaq, është e mundshme që diçka e tillë nuk vlen për ata që fabrikojnë lajme të rreme. Aspak nuk e kanë vështirë të prodhojnë edhe sondazhe të kësaj marke, apo t'i interpretojnë sipas qejfit të tyre dhe inateve akute ose kronike. Në mirëpresim të gjitha hulumtimet e opinionit publik që kanë kriter profesionalizmin dhe paanshmërinë", është shprehur ai.

Duke folur për Konventën e Nëntë Zgjedhore të PDK-së, e cila do të mbahet të dielën, ai ka thënë se do të ketë edhe risi. "Momenti më i rëndësishëm do të jetë zgjedhja e kryetarit me mandat të plotë, si dhe e Këshillit Drejtues. Po kaq të rëndësishme do të jenë edhe miratimi i Statutit të Ri, i

Programit Politik dhe i Deklaratës Politike, dokumente strategjike këto që reflektojnë vlerat dhe orientimet tona në Dekadën e Re, të tretën të lirisë dhe të dytën të pavarësisë. Edhe kësaj radhe do të ketë risi me të cilat PDK-ja përsëri do të shquhet si partia me peshën më të madhe vendimmarrëse dhe shtetzhvilluese në vend", ka thënë Stavileci.

**"Epoka e re":** Z. Stavileci, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të dielën do ta mbajë Konventën e Nëntë Zgjedhore. Cilat organe do të zgjedhen në këtë konventë?

**Stavileci:** Partia Demokratike e Kosovës pas një procesi shembullor dhe masiv zgjedhor të dielën e mban konventën dyditore, me ç'rast kurorëzohet ky proces shumëmuajsh zgjedhor, nga i cili do të dalin

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, e ka vlerësuar shumë të suksesshëm procesin e brendshëm zgjedhor të kësaj partie. Ai ka bërë me dije se ky proces ka bërë që të shtohet mbështetja dhe besimi i elektoratit për të parin e kësaj par-

tie. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Stavileci ka thënë se Kadri Veseli është lider i pakontestueshëm i PDK-së. "Kryetari, z. Kadri Veseli, është lider i pakontestueshëm i PDK-së. Edhe para procesit zgjedhor edhe gjatë procesit zgjedhor të gjitha degët dhe strukturat e reja drejtuese i kanë dhënë një mbështetje të fuqishme kryetarit të tashëm dhe të

ardhshëm të PDK-së. Platforma politike që ai ka dizajnuar, fryma dhe energjia që ai ka sjellë, ruajtja e harmonisë dhe krijimi i sinergjisë mes kuadrove partiake, kanë ngjallur një besim edhe më të madh të njerëzve për vizionin dhe misionin e tij", ka thënë Stavileci.

Ai ka deklaruar se sondazhet profesionale e nxjerrin PDK-në si subjekti i parë politik në

# Antestueshëm i PDK-së

Veseli, është lider i pakontestueshëm i PDK-së. Edhe para procesit zgjedhor edhe gjatë procesit zgjedhor të gjitha degët dhe strukturat e reja drejtuese i kanë dhënë një mbështetje të fuqishme kryetarit të tashëm dhe të ardhshëm të PDK-së. Platforma politike që ai ka dizajnuar, fryma dhe energjia që ai ka sjellë, ruajtja e harmonisë dhe krijimi i sinergjisë mes kuadrove partiake, kanë ngjallur një besim edhe më të madh të njerëzve për vizionin dhe misionin e tij të qartë dhe të palëkundur për një shtet zhvillimor, për një shtet ligjor, për një shtet të integruar në familjen e madhe perëndimore.

**"Epoka e re": Cili ka qenë qëllimi i zgjedhjeve të brendshme të PDK-së dhe sa është arritur ky qëllim me përfundimin e këtij procesi?**

**Stavileci:** Procesi i sapopërfunduar në të gjitha degët me një sukses maksimal ka pasur për qëllim krijimin dhe legjitim-

imin e strukturave të reja drejtuese, të cilat do ta udhëheqin partinë dhe vendin në proceset e ardhshme politike, ku përsëri PDK-ja do ta ketë rolin prijës me politika konkrete për zhvillimin e shtetit tonë të ri, me rivizionimin për ekonominë, edukimin e shëndetësinë, si dhe luftën kundër korrupsionit, nepotizmit, krimin të organizuar dhe dukurive të tjera negative deri në çrrënjosjen e tyre totale. Shembullin që kemi dhënë në këtë proces me 50 mijë njerëz që gravituan rreth Dekadës së Re, i paraprirë nga procesi zgjedhor në kuadër të Rinisë Demokratike me 20 mijë të rinj, me mbajtjen e mbi 3 000 takimeve anekënd Kosovës, është dëshmia kryesore e PDK-së, si partia numër një në vend.

**"Epoka e re": Sondazhet e fundit PDK-në nuk e kanë nxjerrë parti të parë. Sa do të ndikojë ky proces i brendshëm zgjedhor në perceptimin e qytetarëve për këtë parti?**

**Stavileci:** Përkundrazi, son-

dazhet e fundit, profesionale dhe objektive, kanë dëshmuar se PDK-ja është partia e parë. Ndërkaq, është e mundshme që diçka e tillë nuk vlen për ata që fabrikojnë lajme të rreme. Aspak nuk e kanë vështirë të prodhojnë edhe sondazhe të kësaj marke, apo t'i interpretojnë sipas qejfit të tyre dhe inateve akute ose kronike. Ne mirëpresim të gjitha hulumtimet e opinionit publik që kanë kriter profesionalizmin dhe paanshmërinë. Njerëzit i besojnë PDK-së shumë. Të vetëdijshëm për këtë ne kemi forcën për ta zhvilluar e integruar atdheun tonë, por edhe për ta përmirësuar veten. Imagjinoni, ka pasur kuvende me nga 1 500 pjesëmarrës dhe kanë kaluar pa asnjë problem, ndërkaq po i shohim disa parti që s'mund t'i menaxhojnë as 30 njerëz brenda një procesi e, për më keq, as t'i evitojnë përleshjet fizike. Edhe ky është një tregues se si funksionon organizata jonë dhe se sa shumë

dallojmë nga partitë e tjera. Prandaj, njerëzit na besojnë.

**"Epoka e re": Ka pasur vlerësime të ndryshme që pas zgjedhjeve të brendshme PDK-ja mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja. Cilat janë gjasat që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme?**

**Stavileci:** PDK-ja do të vazhdojë të luajë një rol esencial në të gjitha zhvillimet. Rol produktiv dhe konstruktiv që e ka veçuar, po e veçon dhe do ta veçojë gjithmonë. Në kohën kur vendi ka nevojë më shumë se kurrë për unitet dhe konsensus rreth temave të vështira, problemeve të pazgjidhura dhe sfidave delikate, PDK-ja do ta ketë fjalën kryesore, do t'i marrë veprimet e duhura dhe do të jetë në nivelin më të lartë të detyrës. Vendi ka nevojë për unitet dhe konsensus. Për programe të reja. Për ide të reja. Për energji të reja. E PDK-ja do të jetë përsëri lokomotiva e tyre në dekadën e ardhshme të shtetit tonë.

## Kosova dhe Çekia lidhin marrëveshje të bashkëpunimit ekonomik

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRAGË, 14 QERSHOR

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka takuar të premtën kryetarin e Dhomës së Deputetëve të Parlamentit të Republikës së Çekisë, Radek Vondracek, në ditën e dytë të vizitës zyrtare. Në takim u bisedua për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve të dy vendeve dhe shkëmbimin e përvojave.

Ministri Pacolli ka vlerësuar se Parlamenti i Çekisë mund ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj të integrimi evropiane dhe në përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me BE-në. Gjatë takimit u bisedua hapur për bashkëpunimin e dy vendeve në fusha të ndryshme dhe për krijimin e një grupi të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Çekisë. "Thellimi i bashkëpunimit në fushën e ekonomisë dhe të investimeve me Çekinë ka një rëndësi të veçantë, andaj kërkoj nga kryetari i Parlamentit më shumë prani çeke në Kosovë dhe më shumë Evropë në Kosovë", ka thënë ministri Pacolli, duke shtu-



ar se mbështetja e Republikës së Çekisë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe Këshillin e Evropës dhe mekanizmat e sigurisë, si në Interpol ka një rëndësi të veçantë.

Duke falënderuar për mikpritje, ministri Pacolli ka ftuar për vizitë në Kosovë kryetarin e parlamentit çek. Pacolli gjatë ditës ka vizituar edhe Senatën e Parlamentit të Republikës së Çekisë, një prej institucioneve më mbështetëse të

Republikës së Kosovës. Aty është pritur nga nënpresidenti i Senatit, Jiri Ruzicka dhe anëtarët e delegacionit të tij, ku është biseduar për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

I shoqëruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, ministri Pacolli ka theksuar se Kosova është mirënjohëse për gjithë ndihmën që Republika e Çekisë i ka dhënë Kosovës që prej përfundimit të luftës, njëkohësisht për angazhimin e saj për

vendosjen e bashkëpunimit ekonomik që do t'i përafroje dy vendet tona me shumë. "Është e rëndësishme që ta thellojmë bashkëpunimin ndërparlamentar dhe ta përgatisim rrugën e integrimi evropiane bazuar në praktikën e mira të Republikës së Çekisë", ka thënë Pacolli. Me bashkëbiseduesit u folën edhe tema të ndryshme të bashkëpunimit, me theks edhe në bashkëpunimin në fushën e arsimit.

organet e reja drejtuese të partisë. Ditën e parë do ta kemi pjesën e punës, ndërsa ditën e dytë pjesën solemne. Momenti më i rëndësishëm do të jetë zgjedhja e kryetarit me mandat të plotë, si dhe e Këshillit Drejtues. Po kaq të rëndësishme do të jenë edhe miratimi i statutit të ri, i programit politik dhe ai i deklaratës politike, dokumente strategjike këto që reflektojnë vlerat dhe orientimet tona në Dekadën e Re, të tretën të lirisë dhe të dytën të pavarësisë. Edhe kësaj radhe do të ketë risi me të cilat PDK-ja përsëri do të shquhet si partia me peshën më të madhe vendimmarrëse dhe shtetzhvilluese në vend.

**"Epoka e re": Deri më tash kandidatun për kryetar të PDK-së e ka shpallur vetëm kryetari aktual, Kadri Veseli. A prisni që Veseli të ketë kundërkandidat?**  
**Stavileci:** Kryetari, z. Kadri

## MPB-ja, qytetarëve: Në stinën e verës të jeni vigjilent ndaj zjarrvënieve

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kërkuar nga qytetarët të jenë aktivë në parandalimin e çfarëdo lloji të zjarreve dhe zjarrvënësve. "Tashmë kemi hyrë në sezonin e verës, që supozohet se do të karakterizohet me temperatura të larta të ajrit, të cilat ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zgjerimin e vrullshëm të zjarreve në sipërfaqe të hapura, malore dhe fushore. Me qëllim të evitimit të rrezikut nga zjarri, mbrojtjes të jetës së qytetarëve, të pronës, shtazëve dhe ambientit, apelojmë që të gjithë jemi të kujdesshëm dhe vigjilentë për shmangien e të gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit, vërejtjen dhe lajmërimin me

kohë, si dhe të ndihmojmë në shuarjen e zjarreve", është thënë në komunikatën e MPB-së. MPB-ja ka njoftuar se për çfarëdo lloji të zjarri të thërrasin në Qendrën Operative Emergjente nëpërmjet numrit emergjent - 112. "Këtë numër emergjent - 112 mund ta thirrni dhe merrni, pa prefiks, nga cilido qoftë vend apo pozitë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, mund të thirrni edhe në këta numra: Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në numrin e telefonit 193; Policinë e Kosovës në numër të telefonit 192; Ndihmën e shpejtë në numër të telefonit 194. Të gjitha thirrjet janë pa pagesë. Zjarrvëniet e qëllimta, si dhe ato të shkaktuara nga pakujdesia, janë vepër penale dhe sanksionohen me ligj", është theksuar në njoftimin e MPB-së.



### KAMPI DIASPORA

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike

20 - 24 Korrik 2019  
Rugovë - Pejë

### SHKOLLA VERORE

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike

5 - 9 Gusht 2019  
Rugovë - Pejë

## Në muajin korrik organizohet shkolla verore për nxënësit dhe të rinjtë nga diaspora

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka njoftuar bashkatdhetarët se gjatë verës, përkatësisht në fund të muajit korrik dhe në fillim të muajit gusht, organizon një kamp dhe një shkollë verore për nxënësit dhe të rinjtë nga diaspora, të cilat do t'u mundë-

sojnë të krijojnë lidhje të reja shoqërore. Kjo ministri ka njoftuar se gjatë qëndrimit në vendlindje ata do të kenë aktivitete të shumta në funksion të edukimit të tyre, që t'ua forcojë edhe më shumë ndjenjën e dashurisë dhe të respektit për njerëzit dhe vendin e prejardhjes. "Në këtë

kamp -shkollë do të ketë aktivitete të ndryshme arsimore dhe sportive. Të dyja këto aktivitete ofrohen pa pagesë. Pjesëmarrësit do të jenë të moshës 13-17-vjeçare. Aplikimin për kamp - shkollë duhet të bëhet tash", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Diasporës.

## QKUK-ja dhe 'Base Agency' ofrojnë pako me produkte për nënat që lindin në Gjinekologji

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) dhe 'Base Agency' të premtën kanë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit përmes së cilës do të bëhet dhurimi i një pako për secilën nga nënat që lindin fëmijët e tyre në Klinikën e Gjinekologjisë. Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka falënderuar 'Base Agency' që ka zgjedhur

Klinikën e Gjinekologjisë për t'i ndihmuar nënat dhe foshnjat e porsalindura. Në anën tjetër, Alban Shabani nga 'Base Agency' ka thënë se falë donatorëve kanë krijuar një pako e cila do të përmbajë produkte që do t'u dhurohet falas nënat që lindin në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, afërsisht 10 000 pako për gjatë një viti. Dhurimi i pakove për nënat që lindin në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike do të fillojë brenda pak ditësh.



## Sot i jepet lamtumira e fundit profesoreshës Mandushe Berisha

Prishtinë, 14 qershor (ER) - Në moshën 77-vjeçare ka ndërruar jetë prof. dr. Mandushe Berisha. Profesoresha Mandushe Berisha

ishite mbi 40 vjet mësimdhënëse e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, e lëndëve të kimisë. Ishte ndër mësimd-

hënëset e para universitare në Kosovë. Varrimi i të ndjerës bëhet sot (e shtunë) në orën 17:00.

Mbledhja përkujtimore për të ndjerën mbahet të hënë, më 17 qershor, në orën 11.00, në sallën solemne të Fakultetit të Filologjisë.



Presidenti Hashim Thaçi ka dekoruar rreth 50 personalitete të Shqipërisë që kanë kontribuar për lirinë e Kosovës

## Thaçi: Pa kontributin e Shqipërisë, Kosova nuk do të ishte e lirë dhe e pavarur

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pa rolin e Shqipërisë, Kosova nuk do të ishte as e lirë dhe as e pavarur. Ai ka theksuar se pa mbështetjen e Shqipërisë rrugëtimi i Kosovës në NATO dhe BE do të jetë shumë më i vështirë. Këto komente presidenti Thaçi i ka bërë të premtën në Tiranë me rastin e dekorimit me 'Urdhrin e Pavarësisë' të rreth 50 personaliteteve të Shqipërisë për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës



**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 14 QERSHOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, të premtën në Tiranë i ka dekoruar rreth 50 personalitete që kanë kontribuar për lirinë e Kosovës. Me këtë rast, ai ka thënë se kontributi i shtetit shqiptar, i gjithë qytetarëve të Shqipërisë për lirinë e Kosovës, ka qenë shumë i madh. "I filluam këto ditë të kremtimit të 20-vjetorit të lirisë së Kosovës së bashku me miqtë ndërkombëtarë, me mesazhet e presidentit Clinton, mesazhet e zyrtarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për përpërimin e arritur në Kosovë, për storien e suksesit të përbashkët vendor dhe ndërkombëtar, si dhe për sigurinë për të vazhduar tutje me përpërimin, me zhvillim, me vlera euroatlantike dhe me Kosovën vend të pavarur dhe sovran, si kontribuuese e jashtëzakonshme për paqen dhe stabilitetin në tërë Ballkanin Perëndimor, me vizion të qartë për të qenë në të ardhmen e afërt pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian, OKB-së dhe në raporte gjithmonë speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", është shprehur Thaçi.

Ai ka shprehur mirënjohje të lartë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për NATO-n dhe të gjithë partnerët e tjerë që kanë

ndihmuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Një gjë është e qartë, pa rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pa rezistencën e armatosur të luftëtarëve të lirisë, të vajzave dhe të djemve të Kosovës, që ndikuan të mobilizohet populli i Kosovës, të bashkohet si kurrë ndonjëherë në histori, nuk do ta kishim këtë liri dhe nuk do ta kishim as intervenimin e NATO-s. Ju e dini, ne kemi zhvilluar shpesh kryengritje, por kryengritjet tona kanë qenë lokale dhe pa ndonjë vizion të qartë politik dhe pa mbështetje të partnerëve. Kësaj radhe, UÇK-ja bashkoi popullin e Kosovës, UÇK-ja bashkoi të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë, qoftë në Shqipëri, qoftë në Maqedoni, qoftë në Preshevë, qoftë në Mal të Zi, qoftë në diasporë. Të jeni të sigurt se kur kombi shqiptar u bashkua rreth luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit të Kosovës për liri, atëherë edhe ndërkombëtarët u vunë në lëvizje dhe këtu kemi dëshmitarë të këtyre angazhimeve, përfaqësuesit më të denjë të këtij angazhimi kombëtar për liri, për pavarësi të Kosovës. Prandaj, ju shpreh mirënjohje secilit prej jush personalisht për rolin e jashtëzakonshëm edhe diplomatik, edhe politik, edhe ushtarak, edhe në të gjithë segmentet që ndikuan që bota të na përkrahë edhe më tepër", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti ka thënë se duhet të

jemi mirënjohës ndaj botës që na ndihmoi, por edhe të kemi një vlerësim për atë që ndodhi sepse, sipas tij, për herë të parë është arritur që të vihet në lëvizje NATO-ja. Kjo nuk do të ndodhte pa kontributin dhe rolin dinjitoz të Shqipërisë. "Prandaj, pa rolin e Shqipërisë, Kosova nuk do të ishte as e lirë, nuk do të ishte as e pavarur. Sikurse, pa mbështetjen e Shqipërisë, rrugëtimi ynë për NATO dhe Bashkim Evropian edhe tani do të jetë shumë më i vështirë. Prandaj, ishim bashkë në periudhat më të rënda për kombin tonë, për lirinë dhe

pavarësinë e Kosovës dhe jam i bindur se do të kemi rrugëtim të përbashkët edhe për NATO-n, edhe për Bashkim Evropian, me mbështetje të plotë të Shqipërisë", ka thënë presidenti Thaçi, duke shprehur mirënjohje dhe falënderim për çdo familje shqiptare në Republikën e Shqipërisë. "I shpreh mirënjohje dhe falënderim çdo familje shqiptare që hapi derën, hapi zemrën për shqiptarët nga Kosova, të cilët u detyruan të zhvendosen nga spastrimi etnik i Slllobodan Millosheviqit, kur kryente gjenocid në Kosovë.

Dëshiroj të falënderoj secilin prej jush që e thatë të vërtetën kudo që kishit mundësitë, nga përgjegjësitë institucionale që kishit, qoftë në institucione, qoftë në media apo në diplomaci. Ishit së bashku me neve në Rambuje, ishit së bashku me neve gjatë bombardimeve të NATO-s, ishit së bashku me neve në mbështetje edhe operative për luftëtarët e lirisë së Kosovës. Faleminderit, Shqipëri! Faleminderit popullit të Shqipërisë për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka theksuar presidenti Thaçi.

### Personalitetet e dekoruara me 'Urdhrin e Pavarësisë'

Presidenti i Kosovës i ka dekoruar me 'Urdhrin e Pavarësisë' Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Aleksandër Meksini, Anastas Angjelin, Arben Malajn, Arben Rakipin, Artan Meçnin, Artan Myftiun, Artur Zhejin, Bashkim Finon, Bashkim Zenelin, Blendi Klosin, Eduard Mazin, Epir

Luzin, Fatmir Kumbaron, Fatos Klosin, Fatos Nanon, Xhavit Sinanin, Peliks Baçin, Frederik Ymerin, Gazmend Demin, Gëzim Podgorica, Gjok Bunën, Ilir Cepanin, Ilir Mustafarajn, Ilirjana Teloqanon, Kastriot Islamin, Kiço Blushin, Kristaq Porodinin, Kudusi Lamën, Luan Hajdaragën,

Leonard Demin, Maliq Doçin, Neritan Cekën, Paskal Milon, Perikli Tetën, Petrit Bushatin, Petro Koçin, Refik Pucajn, Remzi Bajramdemajn, Sabit Brokajn, Skënder Gjinushin, Sokol Barajn, Sokol Pogën, Shaban Brahën, Shefqet Dizdarin dhe Adem Qopanin.

## Kosova merr kryesimin e Iniciativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI)



**SARAJEVË, 14 QERSHOR (ER)** - Në Sarajevë të Bosnje-Hercegovinës u mbajtën punimet e nivelit më të lartë vendimmarrës të Iniciativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI). Në këtë takim Bosnja e Hercegovina i dorëzoi Kosovës kryesimin njëvjeçar me këtë iniciativë.

Gjatë fjalimeve të mbajtura nga përfaqësues të vendeve anëtare të MARRI-t, përfshirë këtu edhe Serbinë, nuk pati asnjë kundërshtim. Në adresimin e tij, ministri i Brendshëm i Republikës së Kosovës, Ekrem Mustafa, ka konfir-

muar qartë rrugën evropiane për të cilën është përcaktuar Kosova, kurse një herë edhe falënderoi kryesuesin e deritanishëm Bosnje-Hercegovinën për organizimin e këtij takimi. Ministri Mustafa posaçërisht ka përmendur rëndësinë e projekteve të financuara nga GIZ-i dhe organizata të tjera. Pas dorëzimit të kryesimit nga përfaqësuesit e Bosnje-Hercegovinës te përfaqësuesit e delegacionit të Kosovës, ministri Mustafa mori kryesimin e takimit. Në fjalën e tij, tanimë në cilësinë e kryesuesit të MARRI-t, ministri Mustafa, duke iu

drejtuar përfaqësuesve të vendeve anëtare, u shpreh, ndër të tjera, se bashkëpunimi rajonal është parim kyç dhe vlerë demokratike që duhet përfaqësuar nga vendet e rajonit. "Ju siguroj se me kryesimin e Kosovës, MARRI do të vazhdojë të jetë një instrument i fuqishëm, veç të tjerash, edhe i bashkëpunimit tonë. Sikurse që na lidhin shumë vlera, ajo që është shumë me rëndësi, është e ardhmja e përbashkët, pra Bashkimi Evropian dhe kultivimi i vlerave dhe parimeve të tij", ka thënë ministri Mustafa.

# Guvernatori Mehmeti: Kosova ka

Guvernatorët e bankave qendrore të rajonit kanë diskutuar të premten në Beçiq të Malit të Zi për stabilitetin financiar dhe monetar. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se kriza e fundit globale ka imponuar ndryshimet në agjendat e bankave qendrore. Ai ka theksuar se aktualisht Kosova ka një sistem financiar stabil, i cili çdo ditë e më tepër po luan rolin e tij të rëndësishëm në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të vendit

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**BEÇIQ, 14 QERSHOR** - Në Beçiq të Malit të Zi po mbahet Samiti i ministrave të Financave, guvernatorëve të bankave qendrore të shteteve të regjionit si dhe drejtorëve të administratave tatimore të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në këtë samit po marrin pjesë edhe zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi dhe guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti. Temë diskutimi e këtij samiti ishte: "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, në klimën e rritjes së ngadalësuar në

Eurozonë". Në fjalimin e tij para të pranishmëve, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se kriza e fundit globale ka imponuar ndryshimet në agjendat e bankave qendrore. Guvernatori Mehmeti, përveç të tjerash, ka vënë në dukje se përderisa bankat qendrore të vendeve të zhvilluara aktualisht ballafaqohen me sfida të tjera të politikave monetare, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me një politikë monetare të kufizuar si rezultat i eurizimit unilateral, sfidë kryesore vazhdon të jetë ruajtja e stabilitetit financiar. Marrë parasysh faktin se

Republika e Kosovës ka politikë monetare të kufizuar dhe Banka Qendrore nuk mund të përdoret si kredihënese e instancës së fundit, bashkërisht me Qeverinë e Republikë së Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Financave, është krijuar skema e Mbështetjes Emergjente me Likuiditet për bankat, e cila është themeluar me bashkëfinansim të Qeverisë dhe të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se gjatë vitit 2018 ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4 përqindësh. "Kjo rritje është më e larta në rajon, derisa Banka Qendrore e Republikës



së Kosovës për vitin 2019 parashikon një rritje ekonomike prej 4.2 përqindësh, ku ndikim të rëndësishëm pritet të kenë investimet kapitale nga qeveria, kreditimi bankar dhe remitencat", ka thënë Mehmeti, duke shtuar se aktualisht Kosova ka një sistem financiar stabil, i cili çdo ditë e më tepër po luan rolin e tij të rëndësishëm në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të vendit. "Sektori bankar, si komponent kryesor i sistemit financiar në vend, karakterizohet me rritje të vazhdueshme në të gjithë indikatorët e saj, si: rritje të kreditimit bankar prej 11 përqindësh, rritje të depozitave

prej rreth 9 përqindësh etj. Gjithashtu, treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar në Kosovë qëndrojnë në nivele mjaft të larta, ku treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit janë rreth 18 për qind, niveli i raportit të likuiditetit në fund të vitit të kaluar ishte rreth 39 për qind, përderisa norma e kredive joperformuese në sektorin bankar të Kosovës vazhdon të jetë në nivele të ulëta prej 2.6 përqindësh. Norma efektive e interesit në kredi ka shënuar rënie të theksuar krahasuar me vitet e kaluara. Norma efektive e interesit bazuar në të dhënat e fundit ka rënë në 6.55 për qind, e cila në masë të theksuar

## Lekaj hap dyert e ministrisë për studentët e UBT-së për ta kryer praktikën

**PRISHINË, 14 QERSHOR (ER)** - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të premten ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rektorin e Universitetit të Biznesit dhe Teknologjisë (UBT), Edmond Hajrizi. Përmes saj, studentëve të UBT-së u jepet mundësia që të kryejnë praktikë profesionale në MIT.

Angazhimi i tyre do të jetë në drejtime që lidhen kryesisht me infrastrukturë e transport, si hartim të strategjive, planeve e politikave si dhe zbatim të legjislacionit në fushat përkatëse në përputhje të

standardeve evropiane.

Ministri Lekaj ka thënë se ekspertiza e studentëve të UBT-së do të jetë vlerë e shtuar për dikasterin që ai drejton, me dhënie të kontributit drejt realizimit sa më të mirë të projekteve. Ai ka theksuar gatishmërinë e tij dhe të institucionit që drejton për ofrim të mundësive për aftësim të gjeneratave të reja.

Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, e ka falënderuar ministrin Lekaj për ndihmën e çmueshme drejt forcimit dhe përgatitjes së kuadrove të reja krahas teorisë edhe me anën praktike.





# stabilitet financiar



ka lehtësuar qasjen në financa dhe ka rritur shkallën e ndërmjetësimit financiar", ka deklaruar Mehmeti.

Ai ka shtuar se përpos kësaj, një lehtësim të madh të qasjes në financa e ka dhënë edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, i cili është themeluar me qëllim të garantimit të kredive dhe lehtësimit të qasjes në kredi për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme, që kanë qenë më pak të kredituara dhe me një potencial më të lartë për hapje të vendeve të reja të punës dhe rritje të prodhimit. "Duke qenë se Kosova përdor euron si valutë zyrtare, ndryshimet në politikën monetare nuk

paraqesin ndonjë zhvillim në ndikim të drejtpërdrejtë në Kosovë. Kjo, po ashtu, për faktin se partnere kryesore tregtare të Kosovës vazhdojnë të jenë shtetet e Eurozonës dhe ato të rajonit të cilat kanë valuta, që ruajnë një kurs këmbimi mjaft stabil kundrejt euros. Kjo do të thotë se ndryshimet në kursin e këmbimit të euros nuk kanë shumë ndikim në ekonominë e Kosovës", ka deklaruar guvernatori Mehmeti.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se pjesa dërrmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës janë të denominuara në valutën euro,

prandaj sektori është mjaft i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. "Duke e ditur se mbikëqyrja mikroprudenciale, si e vetme nuk vlerësohet më e mjaftueshme për t'i parandaluar krizat bankare, ne kemi zhvilluar edhe kornizën e politikës makroprudenciale dhe kemi funksionalizuar Komitetin Këshillimor të Politikës Makroprudenciale, si organ bartës i politikës makroprudenciale", është shprehur ai. Gjatë samitit, guvernatori Mehmeti iu është përgjigjur edhe pyetjeve të gazetarëve lidhur me sistemin financiar në Kosovë dhe zhvillimeve të ndryshme financiare.

## Mbahet takimi në mes të Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore për rishikimin e portofolit kreditor

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Ministria e Financave dhe Banka Botërore kanë organizuar të premten tryezë diskutimi me të gjitha ministrinë dhe agjencitë e linjës për rishikimin e portofolit kreditor të projekteve me financim përmes huamarrjes. Në këtë tryezë u diskutua për përparimin e projekteve me financim kreditor nga Banka Botërore, për sfidat si dhe për adresimin për të ardhmen, gjithmonë me objektivin për implementim sa më efikas të të gjitha projekteve në fjalë. Me këtë rast, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije se në partneritet me Bankën Botërore, Ministria e Financave në vazhdimësi është e angazhuar për rritjen e efikasitetit të implementimit të projekteve me fonde të huamarrjes, duke shtuar se edhe prezantimi i sotëm i Raportit të Monitorimit të portofolit kreditor, është me

qëllim të adresimit të çështjeve dhe rritjes së performancës.

Ai ka theksuar se ka përparim të arritur në implementim të marrëveshjeve, por në të njëjtën kohë ka kërkuar angazhim edhe me të madh që ta rrisim edhe më shumë dinamikën e implementimit. Sipas ministrit Hamza, për projektet e Bankës Botërore për pesëmuajorin e vitit 2019 janë disbursuar 5.8 milionë euro. Nëse i referohemi vitit fiskal të BB (1 korrik - 30 qershor), pra afërsisht një vit nga tani, janë disbursuar rreth 11.7 milionë euro.

Dy projekte mund të veçohen se kanë pasur lëvizje shumë pozitive: njëri ka të bëjë me Ministrinë e Shëndetësisë, duke avancuar statusin dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, projekti Ekonomia Digjitale, ku edhe pse është ratifikuar nga Kuvendi në fund të vitit 2018, ka filluar me hapa konkretë drejt zbatimit.



## FMN-ja, faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim një delegacion të Fondit Monetar Ndërkombëtar, kryesuar nga shefja e Misionit për Kosovë, Stephanie Eble, me të cilin ka diskutuar për objektivat në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të stabilitetit financiar në vend, në të cilin aspekt, siç është thënë në takim, Kosova është treguar e përgjegjshme. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e ka falënderuar delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për ndihmën që

ky institucion ia ka dhënë Kosovës në zhvillimin ekonomik duke theksuar se FMN-ja është një partnere e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Me Fondin Monetar Ndërkombëtar kemi një partneritet konstruktiv dhe bashkëpunimi në mes të qeverisë dhe këtij institucioni është i frytshëm. Jemi të lumtur për këtë raport dhe Kosovës i duhet në vazhdimësi mbështetje nga FMN-ja për arritjen e objektivave duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ta rrisim

bashkëpunimin, në favor të rritjes së përkrahjes financiare dhe investimeve të huaja", ka thënë kryeministri Haradinaj. Haradinaj ka theksuar se bashkëpunimi me FMN-në është i rëndësishëm për një funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të stabilitetit buxhetor dhe financiar të Kosovës. Ndërsa shefja e Misionit për Kosovë, Stephanie Eble, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen dhe ka konfirmuar mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën.



# Pesë vjetët e mia me UNDP-në në Kosovë



Alessandra ROCCASALVO,  
përfaqësuese e  
përhershme e UNDP-së  
në Kosovë

Në këto ditë të fundit të shërbimit tim pesëvjeçar në zyrën e UNDP-së në Kosovë, shpesh më pyesin, "a është Kosova një vend më i mirë sesa kur filluat?" Përgjigja ime është po. Gjatë pesë vjetëve të fundit ka pasur përmirësime në institucionet lokale dhe qendrore, në ofrimin e shërbimeve, zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës.

Jam veçanërisht krenare me sukseset që kemi arritur me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes masave dhe programeve tona të Tregut Aktiv të Punës. Gjatë pesë vjetëve të fundit kemi ndihmuar mijëra njerëz përmes trajnimeve në punë, subvencionimit të pagave, granteve të vetëpunësimit dhe skemave të praktikës. Së bashku jemi përpjekur që gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në këto masa dhe programe, sepse sigurimi i pavarësisë ekonomike dhe aftësia për të fituar kafshatën e gojës për familjen tënde bën një ndryshim të madh në jetën e secilit.

Me partnerët tanë në nivel lokal dhe qendror kemi përmirësuar qasjen në drejtësi - veçanërisht për komunitetet e cenuara - përmes rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e njerëzve, zyrate mobile për ndihmë juridike,

ndihmës juridike falas dhe fuqizimit të të rinjve për t'u bërë faktor ndryshimi. Kemi mbështetur sektorin e drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, hartimin e ligjeve të rëndësishme kundër korrupsionit, krijimin e online bazave të të dhënave për regjistrimin e pasurisë dhe trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve më të larta.

Përmes projektit të Sigurisë kemi përkrahur Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës që qytetarët të ndjehen më të sigurt. Themelimi i Pikës së Referimit për Armët e Zjarrit është i pari në rajon dhe kopjohet gjerësisht nga fqinjët e Kosovës. Veçanërisht, tani vonë, fushata e legalizimit ka qenë një sukses në regjistrimin e armëve që më parë ishin të paligjshme, duke siguruar në këtë mënyrë që këto armë të regjistrohen.

Duhet theksuar veçanërisht puna që kemi bërë përmes aktiviteteve tona në fushën e trashëgimisë kulturore. Shumë vendndodhje fetare dhe kulturore në Kosovë janë rregulluar, rehabilituar dhe rinovuar. Ne kemi përkrahur iniciativa fantastike si ruajtja e punimit të filigranit dhe, tani kohëve të fundit, ringjallja e instrumentit antik, okarinës. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve krijohet besimi ndërmjet komuniteteve, rritet toleranca, mirëkuptimi dhe respekti i ndërsjellë.

Është përmirësuar reagimi ndaj rrezikut nga fatkeqësitë si në nivel komunal ashtu edhe në familje nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, trajnimeve dhe stërvitjeve. Përveç kësaj ne kemi mundësuar sigurinë fizike të fshatrave anekënd Kosovës, duke siguruar që përmytjet dhe shirat e mëdha të mos rrezikojnë shtëpitë e njerëzve.

Ajo që na inkurajon shumë është se kohëve të fundit kemi parë një përqendrim të shtuar në mjedis dhe si mund ta mbrojmë atë. Në vitin e kaluar kemi lansuar procesin e co-design, duke përdorur njohuritë dhe entuziazmin e studentëve dhe duke i lejuar ata të krijojnë zgjidhje inovative për disa nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë, së bashku me organizatat tjera të OKB-së, si dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ka pasur përparim të jashtëzakonshëm në Kosovë në shumë nivele, gjë që do të ishte e pamundur pa partnerët tanë. Pra, sot, kur pesë vjetët e mia janë duke përfunduar, kujtoj me dashamirësi të gjithë ata njerëz që më kanë mirëpritur, ushqimin fantastik, dëshirën dhe vendosmërinë e njerëzve për ta bërë Kosovën një vend më të mirë për të gjithë.

## Në cilat raste dhuna seksuale është akt i gjenocidit



Shkruan: Bardhyl  
MAHMUTI

Në kuadër të së drejtës penale ndërkombëtare, dhunimi dhe të gjitha format e dhunës seksuale, që paraqesin cenim të rëndë të integritetit fizik dhe mendor të viktimës, janë të përfshira në të tri kategoritë e krimeve të rënda: krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimin e gjenocidit.

Në rastet kur dhuna seksuale ndodh gjatë një konflikti të armatosur, qoftë të karakterit ndërkombëtar, qoftë të karakterit të brendshëm të përkufizuar në të drejtën humanitare ndërkombëtare, atëherë kemi shkelje të të drejtave themelore të njeriut, të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të protokolleve shtesë I dhe II të vitit 1977.

Ajo që vlen të theksohet lidhur me dhunën seksuale në kuadër të krimeve të luftës ka të bëjë me faktin se përgjegjësia penale është individuale për autorët e krimeve, sepse kjo dhunë nuk është rezultat i një projekti të planifikuar, por akt individual.

Për dallim nga dhunimet e tjera individuale, dhuna seksuale në kuadër të kësaj kategorie cenon njërën nga kategoritë e mbrojtura me këto akte juridike ndërkombëtare. Dhe, si e tillë, është përfshirë në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, [Neni 8, paragrafi (1), pika b-XXII].

Kur dhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale ushtrohen gjatë aksioneve të përmasave të gjëra dhe sistematike kundër një popullsie civile, të cilësdo përkatësi kombëtare qoftë, atëherë kemi të bëjmë me krim kundër njerëzimit, sepse në këtë rast viktima cenohet në atë që është njerëzore në të (Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Neni 7, paragrafi 1 dhe 2, pika g në të dy paragrafët).

Për dallim nga krimet e luftës, aktet kriminale që hyjnë në kategorinë e krimeve kundër njerëzimit mund të kryhen edhe në kohë paqeje dhe dallojnë nga krimi i gjenocidit për faktin se aktet kriminale të cilësuar si krimet e luftës nuk janë domosdoshmërisht të drejtuar kundër një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar. Vetëm atëherë kur aktet kriminale janë të drejtuar qëllimisht për të shkatërruar një grup të caktuar kombëtar, etnik, racor apo religjioz si të tillë përbën krim të gjenocidit.

Cenimi i integritetit fizik dhe mendor i anëtarëve të një grupi caktuar kombëtar, etnik, racor apo religjioz, si të tillë, përbën

gjenocid në përputhje me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Neni II, paragrafi b). I njëjti përkufizim është përfshirë tekstualisht edhe në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare [Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Neni 6, paragrafi (b)] ndërsa, në sqarimet e dhëna rreth asaj se cilat akte hyjnë në këtë kategori, në dokumentin e Kombeve të Bashkuara të titulluar "Elemente të krimeve", thuhet:

"Elementet e gjenocidit përmes cenimit të integritetit fizik dhe mendor janë në rastet kur: 1.

Autori i krimit ka cenuar rëndë integritetin fizik dhe mendor të një personi apo të më shumë personave; 2. Ky person ose këta persona i takojnë një grupi kombëtar, etnik, racial fetar të veçantë; 3. Autori i krimit kishte për qëllim të shkatërrojë tërësisht ose pjesërisht këtë grup kombëtar, etnik, racial fetar; 4. Sjellja e tillë është bërë në kuadër të një serie të veprimeve të ngjashme të drejtuar kundër këtij grupi, apo që mund ta shkaktonte një shkatërrim të tillë.

Pa u kufizuar në format e shfaqjes, kjo sjellje përfshin aktet e torturës, të dhunimit, të dhunës seksuale, të trajtimeve çnjerëzore ose degraduese" (Vepra e cituar në shkrimin paraprak "Éléments des crimes, Publication

de la Cour pénale internationale, f. 2).

Me një fjalë, vetëm format e torturave, poshtërimeve, degradimeve që u bëhen anëtarëve të një grupi kombëtar, etnik, racial, fetar dhe që kanë për qëllim shkatërrimin e grupit si të tillë hyjnë në kategorinë e krimit të gjenocidit. Ajo që është më rëndësi të thuhet lidhur me gjenocidin përmes dhunës seksuale, si formë e cenimit të integritetit fizik dhe mendor, ka të bëjë me faktin se në këtë kategori nuk hyn dhuna seksuale që është bërë si akt individual për shfryrje të epsheve, por aktet e planifikuara me qëllim të shkatërrimit të cilitdo nga grupet e lartpërmendura.

Pikërisht për këtë arsye, preokupimi i strukturave që kanë planifikuar dhe zbatuar planin e gjenocidit është fshehja e krimeve. Meqenëse në Kosovë viktimita ishin evidente, strategjia e Serbisë dhe mbështetësve të tyre ishte minimizimi i numrit të viktimitave dhe zhvendosja e përgjegjësive nga shteti, në grupe dhe individë ("paramilitarëve") që gjoja ishin jashtë kontrollit shtetëror.

Rrëfimet publike në disa raste të dhunës seksuale në Kosovë e dëshmojnë më së miri këtë strategji. Gjatë disa dhunimeve kemi "ndërrhyrjen" e eprorëve ushtarakë serbë duke i "qortuar" ata që kryenin dhunimet dhe i trajtonin si "pisa". Madje kemi raste kur kriminelet prezantohen

si "të dehur ose nën ndikimin e substancave narkotike". Në këtë mënyrë shteti serb përpiqet t'i prezantojë si veprime individuale aktet e dhunës seksuale dhe ta mohojë vërtetësinë e planifikimit dhe ekzekutimit të dhunës me qëllim të shkatërrimit të shqiptarëve si komb, si etni, si fe e ndryshme prej tyre.

Dihet se dhuna seksuale ka pasojë të rënda për viktimën. Por, kur dhuna seksuale hyn në funksion të strategjisë së shkatërrimit të një grupi, siç ishin dhunimet e shqiptarëve në Kosovë, atëherë qëllimi i dhunimeve seksuale nuk është vetëm shkatërrimi i viktimitave të drejtpërdrejta, por nëpërmjet dhunimeve synohet të cenohet integriteti mendor edhe i të afërmeve të viktimitave, i tërë grupit, i të gjithë shqiptarëve. Vetëm në kuadër të këtij qëllimi mund të shpjegohen dhunimet e meshkujve dhe detyrimet e dhunimeve brenda anëtarëve të së njëjtës familje, ku prindi shtrëngohej të bënte marrëdhënie seksuale me fëmijën e vet dhe anasjelltas.

Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm kur përpiqemi të hedhim dritë mbi këtë formë të gjenocidit, sepse rrezikojmë të individualizojmë një krim të planifikuar nga shteti. Fatkeqësisht, kemi raste kur viktimitat e dhunës seksuale kanë rënë viktimë e strategjisë së shtetit serb dhe deklarojnë se janë dhunuar nga "paramilitarë". Tragjedi e dyfishtë!

# Kur ora kthehet mbrapshtë nga njerëz të mbrapshtë!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

Kush luftoi dhe kush mrizoi: Sikur në asnjë vend të botës, në Kosovë, 20 vjet pas përfundimit të luftës, janë rikthyer debatet se kush e nisi luftën, kush e bëri luftën dhe kush e fitoi luftën. Në këtë debat të pavlerë, më agresivët janë ata që, jo se nuk bënë asgjë për luftën, por e penguan atë. Këtë po e bëjnë për faktin se fituan hapësirë për këtë pikërisht nga ata që e bënë dhe u sakrifkuan për luftën, por se nuk u gjetën si duhet në kohën e paqes për faktin se një numër i tyre u përfshinë në aktivitete të krimit të organizuar, korrupsion, e shndërruan nepotizmin në rregull dhe standard moral e sidomos e çkryen Kosovën përmes procesit të privatizimit. Ata që në kohën kur fasulja hahej kokërr për kokërr, komandantin legjendar Adem Jasharin e identifikonin me paramilitarë të Serbisë e që Bacën e Madh, Frymëzuesin, Vetëdijen dhe Ndërgjegjen Kombëtare, Adem Demaçin, e konsideronin marksist, enverist dhe mbanin mbledhje, duke e cilësuar më të rrezikshëm se vetë Serbia, sot po shiten si bartës të luftës të cilën nuk e bënë asnjëherë. Po këta horra të luftës dhe të paqes, komandantin legjendar, Adem Jasharin, përpiqen ta bëjnë ushtar të Ibrahim Rugovës ndonëse e kanë të qartë se sa për Rugovën në Kosovë nuk do të bëhej luftë as në 5 000 vjetët e ardhshëm. Nuk e them se Rugova nuk e ka dashur lirinë e Kosovës dhe shqiptarëve, por e them se nuk ka qenë në gjendje të marrë përgjegjësi siç mori Izetbegoviçi në Bosnje apo Tugjmani në Kroaci. Ose, në variantin më të butë, nuk ishte në gjendje të merrte përgjegjësi as sikur Kuçani në Slloveni, ndonëse që të dy ishin komunistë me bindje dhe në veprim. Prandaj duhet të bëhet një ndarje e saktë midis atyre që e bënë luftën dhe atyre që mrizuan para, gjatë dhe pas luftës ndërsa, sot i ndajnë dekorata patriotizmi vetes sikur të kishin qenë ushtarë të Xhngis Kanit që e

pushtuan gjysmën e botës e jo dele të metilosura që mrizonin në shtetet perëndimore duke u paguar nga Fondi i 3 përqindëshit apo duke bërë sfilata "ushtarake" në Shqipëri pas së cilës, ndonëse humbën jetën në aksidente trafiku apo mënyra të tjera e që nuk kishin lidhje fare me veprime ushtarake, sot, për turpin e tyre, janë veteranë të UÇK-së si dhe janë shpallur edhe heronj të Kosovës. Lexova diku se edhe legjendari Fehmi Lladrovci po nëpërkëmbet dhe fyhet rëndë nga matufë biologjikë dhe tartufë kombëtarë dhe njerëzorë sepse nuk paska qenë një linjë me Rugovën. Edhe nuk ka qenë sepse kanë ndryshuar diametralisht, Rugova ishte i mrizit, Feha me Xhevë Lladrovcin ishin të zjarrit që e dëshmuuan me rënien e tyre heroike. Rugova nuk ishte komandant, prandaj nuk ishte as ushtar, kurse Fehmi dhe Xhevë Lladrovci kishin komandantë politikë Bacën Adem Demaçi kurse ushtarak, komandantin legjendar Adem Jashari. Tash është e ulët të ndahen luftëtarët në baza partiake sepse në kohë të vështira kombi ishte mbi të gjitha e jo përcaktimi partiak apo politik. Sot flitet për FARK-un (Forcat e Armatosura të Kolumbisë) dhe UÇK-në, Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Sipas strategëve të mrizit, vetëm FARK-u paska bërë luftë, ndërsa UÇK-ja jo. Gënjeshtër ordinere dhe mburravecëri prej bibani. Në Kosovë nuk ka pasur asnjë ushtar me uniformë të FARK-ut! Mbase kanë mundur të kenë brekushe apo të linjta me mbishkrim FARK. Kush e ka dashur lirinë e Kosovës dhe kush ka qenë me përmbajtje kombëtare nuk ka pasur kohë të qëndisë shkronja në uniformat e tyre. Çfarë rëndësie ka se çfarë pozicioni politik ka pasur Agim Ramadani, Sali Çeku dhe të tjerët kur vepra e tyre si dhe sakrificat sublime i ka shndërruar në heronj duke i bërë pjesë të përjetësisë! Sa të jetë njerëzimi dhe shqiptaria, heronjtë dhe ata që u sakrifkuan për liri, pavarësisht se me çfarë gjuhe politike flisnin, do të jenë në secilin nga ata që e duan, e respektojnë, e kultivojnë, e përkujtojnë dhe nuk e harrojnë lirinë, si detyrim moral, kombëtar dhe njerëzor! Historinë e shkruajnë ata që e bënë me gjak dhe sakrificat, kurse nga ajo përfitojnë ata që ishin kundër kësaj historie apo një historie tjetër apo që e bëjnë fotokopje ose xerox histori! Me një fjalë, horra të

pasluftës e të tillë ka shumë! Lexova diku se Rugova paska bërë lista për ushtrime ushtarake në Shqipëri e që është mashtrim ordiner kur dihet se pikërisht Rugova ishte 100 për qind kundër luftës, jo pse nuk e dëshironte, por se i mungonte gatishmëria për sakrificë dhe përgjegjësi! Rugova ishte patriot i paqes dhe jo i luftës, në ndërkohë që rruga drejt paqes domosdoshmërisht kalon përmes luftës. Sot Rugovën e madhërojnë ata që nuk e kanë dashur kurrë, që nuk e kanë respektuar dhe që i kanë bërë njëqindmijë probleme! Sot Rugovën, në mungesë të ofertës politike, e përdorin dhe keqpërdorin vetëm për vota, në luftë për pushtet dhe jo për shtet. Se këtë e bëjnë një pjesë komuniste e LDK-së e që për mua nuk paraqet problem, por se këtë e bënë edhe një pjesë e krahut të luftës e që në rrethana të atëhershme, po ta zinin Rugovën, do t'ia bënin lëkurën për def apo tupan, është pafytyrësi antologjike! A ishte Zahir Pajaziti ushtar i Rugovës: Po thuhet se Zahir Pajaziti ishte ushtar i Rugovës apo pjesë e listës për ushtrime ushtarake në Shqipëri e që e kishte bekimin e Rugovës. Duhet të jeni, së paku në nivelin e tretë të çmendurisë e ta besoni këtë. Në atë kohë listat për ushtrime ushtarake në Shqipëri i ka bërë Baca Ahmet Haxhiu, një patriot i pashembullt sikur që edhe furnizimi me armë ka shkuar kryesisht përmes Bacës Ahmet e që për këtë prapa qëndronte Baca Adem Demaçi. Edhe unë, pas daljes nga burgu thuaja 9-vjeçar e që paqësorët na thoshin se nuk ishim në burg, por se ishim në hotele, së bashku me gruan time Fexhrien, e cila ishte torturuar thuaj 12 muaj nga vëllai i bashkëthemeluesit të UJD-it, si e burgosur politike, ishim në lista për ushtrime në Shqipëri. Unë, nga hija, së bashku me Bacën Ahmet Haxhinë shpërndanim armë në Llap dhe Gollak, me veturat e Bacës Ahmet. Realisht, armët ua shpërndanim për pesë minuta, ndërsa kur shkoni t'ua merrim prapa, për faktin se nuk kishin gatishmëri t'i përdornin, duhej të prisnim më shumë se një orë derisa i nxirnim nga vendi ku i kishin fshehur fort. Për fat të mirë, sot ka në mesin e të gjallëve të tillë që i kanë përdorur ato armë, por edhe të tillë që i patën futur shtatë pashë nën dhe që na i kthyen pasi kishin filluar të ndryshken. Këta sot janë

bartës të pozitive të ndryshme, kanë emër dhe mbiemër dhe, nëse ka nevojë, mund edhe t'i bëj publik! Dëshmitarë për këtë dhe bashkëpjesëmarrës shumë të përkushtuar në këto aktivitete ishin Nuhi Llapqini dhe Dul Taraku, shoqërues dhe përkrahës deri në vdekje të Bacës Adem Demaçi dhe Bacës Ahmet Haxhiu. Fëmijët e torturuesve tanë (policë hetues, udbash, inspektorë, prokurorë apo edhe gjykatës që na dënuan) sot janë sistemuar si më së miri; këshilltarë të presidenti, në Kuvendin e Kosovës, kryeministri dhe, në shumicën e rasteve nuk paguhen nga buxheti i Kosovës apo marrin paga të larta, kurse fëmijët tanë kryesisht janë të papunë apo bëjnë punë në kundërshtim me shkollimin që e kanë. Pikërisht për këtë arsye është kthyer situata në favor të atyre që e kundërshtuan, e luftuan dhe e penguan luftën, prandaj edhe po bëjnë përpjekje ta marrin autorësinë e luftës në kohën që nuk e kanë shkrepur as edhe një plumb të vetëm, përjashtuar këtu situatën kur kanë shërbyer në forcat serbe apo kur kanë vrarë ndonjë patriot shqiptar! Po të pyetj Rugova, Zahir Pajaziti kurrë nuk do të bëhej Zahir që e njohim dhe që u sakrifkua deri në vetëflijim, por do të mbetej një aparatçik sikur disa nga këta kasnecët e ish-Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë, të konvertuar në LDK, por edhe në PDK! Sot kryesisht është koha e antivlerave. Vlerat e vërteta nuk përmenden. Komandanti Legjendar Adem Jashari është përzënë nga territori i Prishtinës, kryetari i së cilës e ruan me xhelozë përmendoren e Vëllazërim Bashkimit apo Tregishtërinjtë për të mos i lëshuar vend Adem Jasharit. Baca Adem Demaçi as në atë botë nuk ka qetësi nga matrapazët që e kanë shndërruar varrin e tij në një vendparkim në vend se të bëhet në një vendtakim për ata që e duan lirinë dhe ku do të mësohej historia e vërtetë kombëtare dhe njerëzore. Po pse u bë kështu dhe a mund të bëhej ndryshe: Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Serbia e ruajti strukturën e padëmtuar informative dhe thuaja të gjithë spiunët që i kishte. Këta pastaj u integruan si tërësi në UNMIK e që pastaj u shpërndanë në polici, hetuesi, prokurori dhe gjykata. Thuaja e trashëguan tërë hapësirën mediatike, të shkruar dhe elektronike. U shpërndanë

nëpër ambasada të huaja si këshilltarë dhe përkthyes sikur që u bënë anëtarë të organizatave ndërkombëtare ku punonin kryesisht kundër interesave kombëtare. U bënë opinionistë e analistë, kurvarë dhe zuzarë, intelektualë dhe politikanë, konsuj dhe ambasadorë dhe, pas këtij konvertimi, u bënë patriotë që na linin në hije. Tash, shokët tanë të burgut, vuajtjeve, sakrificës dhe luftës duke bërë përpjekje t'i instrumentalizojnë këto fundërrina njerëzore dhe kombëtare, pahetueshëm e bënë pjesë e kësaj përzierjeje që kundërmonë nga ndyrësira, me një dozë të parfumit kinez. Telefonat celularë i kishin të hapur për ta 24 orë, kurse për shokët e dikurshëm e kishin kurdisur përgjigjen: "personi që e keni kërkuar nuk ka qasje në rrjet...". Një pjesë e shokëve tanë u bënë hajdutë, kriminelë, vrasës, zhvatës dhe pisa shkuar pisave. Sot në Kosovë e keni të vështirë të gëzoni respekt nëse nuk jeni pjesë e nomenklaturës së kriminalizuar, nuk mund të bëni karrierë nëse nuk keni një aktakuzë për korrupsion apo krim të organizuar kurse, majat kur nuk do t'i mbërrini nëse nuk jeni të dënuar me, së paku, tri vjet burg efektiv për aktivitete kriminale! Për faqe të zezë u festua 20-vjetori i lirisë së Kosovës dhe nuk u përmend Adem Jashari, kurse Bacën Adem Demaçi e përmendi në një postim vetëm Xhavit Haliti. Askush nuk përmendi ideologun e politikës dhe filozofisë kombëtare, Ukshin Hotin. Askush nuk përmendi Agim Ramadanin, Xhemajl Fetahun, Sali Çekun, Ilaz Kodrën, Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin, Hafir Shalën, Xhavit Hazirin, Luan e Shkëlzen Haradinaj, Remzi Ademajn dhe të tjerët të cilët edhe me një pordhë të tyre kanë kontribuar më shumë për lirinë e Kosovës se 95 për qind i parazitëve që bënë sfilatë në "Emerald" nën përkujdesjen e Baby Dollit. Çdo kohë i ka heronjtë e vet dhe horrat e vet që e vulosin kohën kur jetojnë dhe veprojnë. Sot, Kosova, në jo pak raste, heronjtë realë i ka zëvendësuar me horra realë. Që të dyja palët janë realë, por se horrat sot janë më realë se realë duke falënderuar pikërisht ata që është dashur t'i luftojnë këta horra e që, në jo pak raste, edhe vetë janë bërë horra. Vlerat e vërteta mbijetojnë çdo kohë, kurse koha pashmangshëm i gjuan horrat aty ku e kanë vendin, në plehra. Pa mundësi riciklimi!

Një intervistë me mikun e madh të shqiptarëve dhe të Kosovës - mikun e Presidentit Historik të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova dhe shkrimtarit të madh Ali Podrimës - Peter Paul Wiplinger, poet i njohur austriak

# Unë do luftoj, sa të kem mundësi, për të vërtetën dhe për drejtësi, për interesat legjitime të të gjithë njerëzve

"... një rebel radikal, për të cilin nuk ishte aq e rëndësishme që ta shpjegojmë botën, mirëpo që ta ndryshojmë këtë botë dhe njerëzit, që të kemi drejtësi, ku të gjithë njerëzit të kanë mundësi të barabarta për një jetë humane."



Intervistoi kohë me parë:  
Mr. sci. **Hazir MEHMETI**,  
Vjenë

**Nacional:** A ju kujtohet, kur keni filluar të shkruani, ishte poezi apo prozë e parë, cili është motivi i saj dhe kur është botuar?

**Wiplinger:** Ishte viti 1946, kur në shtëpinë e prindërve të mi, në shtëpinë e lindjes sime Haslach an der Mühl, 2-3 km larg nga kufiri i Çekoslovakisë së asaj kohe, një ushtarak ebre-rus i strehuar për ndonjë arsye tek ne, më ka mbetur në kujtesë recitimi i tij të elegjive nga Rainer Maria Rilke, dhe unë si djalë i vogël qëndroja ulur pranë dhe dëgjoja me gojë hapur. Ky përjetim më ka prekur thellë dhe ndoshta ishte përcaktues në jetën time. Ka mbetur e pa harruar dhe më shoqëron në pambarim tërë jetën time. Kjo ishte një shtytje në brendësinë e një bote krejt tjetër, sa në banalitetin e përditshëm, aq edhe në vërtetësinë e saj.

Kjo ishte bota e poezisë, e cila më pushton mua plotësisht prapa së cilës qëndron vendimi im për të shkruar poezi dhe të rritem me te. Më vonë vijnë poezitë nga: Erich Kästner, Mascha Kaleko, Charles Baudelaire, Arthur Rimbaud, Paul Éluard, Garcia Lorca etj. Si gjimnazist poezitë e mia i botova në antologji "Flügel der Zeit" dhe "Österreichische Lyrik nach 1945". Përjetimet nga jeta dhe vjershat e poetit austriak Georg Trakl, e forcojnë rrugën time drejtë lirikës dhe shkrimeve të mia përgjithësisht. Poezia e parë si gjimnazist 16 vjeçar, i kushto-

hej natyrës dhe dashurisë. Njërin nga vjershat e dërgova në një gazetë, u botua dhe për këtë isha shumë krenar. Në këtë kohë lexoja poezi të përkryera dhe dëshiroja dhe unë të shkruaj diçka të tillë dhe të bëhem poet. Kjo ishte rruga ime letrare, një rrugë që unë e dëshiroja. Nga poezitë e para më kujtohen disa rreshta: " Nëse yjtë në dorë më bien, një shenjë e sigurt për mua..."

**Nacional:** Nga poezitë e juaja del një qëndrim njerëzor i veçantë në përkrahjen e të drejtës për njeriun pa marr parasysh kush e nga është. Ku e gjeni këtë motiv, forcë?

**Wiplinger:** Ne anën tjetër në këtë kohë ndikonte realiteti i shoqërisë klasore, që ende ishte i pranishëm, kundër së cilës ishte kthyer politikisht edhe socializmi. Shoqëria klasore Kjo shoqëri klasore dhe kushtet e jetës të lidhura me te ishin edhe për familje, një prej të cilës unë i takoja, një famil-

Peter Paul Wiplinger

## Ibrahim Rugova

Ti gjithmonë fole me zë të ulët dhe si përherë kundër çdo dhune por pyes veten a mundet njeriu pa dhunë prej dhunës të mbrohet varka na nxori tek bregu tjetër ngadalë i ngjitëm shkallët lart sa i brishtë qenka njeriu por dhe sa pa përgjigje mendova njëkohësisht (Përktheu: Ajat Shira, Vjenë)



je tregtare dhe krye bashkiaku, një gjë mjaft e natyrshme, si diçka "e dhuruar nga Zoti"; dhe kështu është trajtuar veprimi ynë janë trajtuar edhe shërbëtorët tanë, pra si qytetare të klasës së dytë, si të nënshtruarit tanë-ashti siç dhe në të vërtetë dhe ishin në jetën reale. Kjo më lëndonte ndjenjat e mia të hershme ndaj drejtësisë dhe ngrite kundërshtimin bashkë me indignatën time.

Kundër kësaj u ngrita, u rebelova. U solidarizova me "subjekte" "të nënshtruarit" të tilla e tillë (p.sh. si kuzhinieri ynë i kuzhinierja jonë e dashur Fani, i e cili ka jetuar 35 vjet dhe ka gatuar për familjen dhe bënte gjithë punët e shtëpisë), edhe kundër prindërve dhe kundër familjes.

Për këtë shkak vizioni im u zgjerua në këtë rreth të shtypurish dhe të shfrytëzuar gjithnjë e më shumë, dhe ky

vizion u bë kërkues dhe me i saktë.

Pashë më shumë dhe më shpesh, sidomos degradimin dhe deprivimin, padrejtësinë, shtypjen sheshazi shpesh dhe çnjerëzore: dhe atë në gjithë botën. Unë jam marrë me këtë çështje dhe kjo çështje më ka preokupuar.

Në përfundimin e luftës në vitin 1945 ishte një Europë e shkatërruar shkretëtira me 60 milionë viktima e të vrarë, me fajin e madh në të dy anët, dhe Holokausti, për të cilin ne nuk dinim ende asgjë.

**Nacional:** Përveç poet, ju jeni edhe filozof dhe fotograf, ne veprat e jua gjendët një kontekst shpirtëror për një botë më të mirë. Cila nga këto tri karakteristika ka ndikuar ma shumë tek personaliteti Wiplinger, është ndonjë që ka pas me shumë ndikim? Cili personalitet letrar, artistik,

filozofik apo politik është inspirim për ju?

**Wiplinger:** Në të njëjtën kohë kur fillova të shkruaj poezi gjatë kohës si student, u ballafaqova shumë me filozofinë, përcolla shumë ligjërata, ku merrja njohuri fillestare filozofike. Fakti që vëllai im shumë i talentuar Fridolin, vdiq i ri (1973), ishte profesor në UN e Vjenës i cili ishte nxënës dhe shok i Heidegger, ai ndoqi një drejtim filozofik krejtësisht ndryshe nga unë, me mendimet e mia, me detyroj që mos të futem shumë në filozofi. Ne ishim shumë të ndryshëm në shumë pikë-pamje dhe opinione, dhe ndonjëherë diskutimet u bënin shumë të ashpra. Unë isha i inspiruar nga ekzistencializmi francez (Camus, Sartre), një rebel radikal, për të cilin nuk ishte aq e rëndësishme që ta shpjegojmë botën, mirëpo që ta ndrysho-

jmë këtë botë dhe njerëzit, që të kemi drejtësi, ku të gjithë njerëzit të kanë mundësi të barabarta për një jetë humane. Për mua ishte drejtësia e rëndësishme, kurse jo aq shumë "e vërteta" - definicioni i së cilës shpeshherë e arsjetonte shkëlqen e njerëzve dhe dhunën, jo rrallë edhe duke u bazuar në "vlera" të llojllojshme. Edhe parullat si "Kurrë më!" (Fashizmi/Auschwitz) ishin tonat, gjithashtu edhe thirrja jonë për t'i luftuar pushtuesit, si për shembull "No pasaran", dhe "La Passionara" (Dolores Ibarruri Gomez) nga lufta civile në Spanjë. Ajo pati ndikim në mua dhe në udhën e jetës sime, në eksperiencat dhe "urtësinë e jetës". "Megjithatë!" - një fjalë të cilën unë e mendoj si më të rëndësishmen për mua: "Megjithatë!". Të jemi kryengritës! - edhe atëherë kur jemi të vetëdijshëm se mbase dhe mund të humbim dhe të vdesim. Kjo për më tepër nga ndërgjegjja dhe qëndrimi se të hiqet dorë (dorëzimi/dorëheqja) nuk është opsion, sidomos në këtë botë të sotme, në të cilën rezistenca dhe kryengritja është e vetmja gjë e cila njeriut i jep dinjitet.

**4. Nacional: Disa vepra tuaja janë përkthyer në shumë gjuhë, edhe në shqip, cilën do ta dalloni dhe përse?**

**Wiplinger:** Që herët vjershat e mi u përkthyen në gjuhë të ndryshme dhe u publikuan. Fillim i vargut të gjatë të publikimit të librave të përkthyer në 20 gjuhë nisi me përmbledhjen "Oporoka ?asa" (Zeitvermächtnis) në sllovenisht dikur në ish Jugosllavi. Ne kemi grupet etnike slloven, kroate, çeke dhe grupeve etnike Roma e Sinit, ku ishte me rëndësi botimi i vjershave në këto gjuhë; kjo kishte domethënie për kohën në kontekstin kulturo-politik. Në vitin 1977 botohet dhe publikohet në dy gjuhë "Kufijtë", "Borders / Grenzen", anglisht dhe gjermanisht në New York. Në disa nga vjershat do të flitet për Holokaustin dhe Nacionalizmin socialist. Për këtë nuk dëshironte njeri të dëgjonte në Austri. Ky libër këtu krejt pak tërhoqi vëmendjen, por krejt ndryshe ishte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ishte pikërisht kjo "'Temë" shumë e kufizuar e kohës, e cila në vjershën time programatike ("Pas Aushvicit" (Nach Auschwitz) e formulon konceptin tim karshi qëndrimit të filozofit gjerman Theodor W. Adorno, i cili thoshte: "Të shkruash vjershë pas Aushvicit është barbari" Përkundrazi, unë vendosa të shprehem me



## PETER PAUL WIPLINGER

U lind në lokalitetin Haslach në vitin 1939, jeton në Vjenë. Ka mbaruar studimet në Shkencat Teatrore, Gjermanistikë dhe Filozofi. Është i njohur si Lirik, Publicist kulture e arti dhe fotograf.

Ka botuar deri me tani 46 vepra, kryesisht në poezi, shumë nga të cilat të përkthyer në mbi 20 gjuhë. Në shqip "Shënja Jete" (Lebenszechen). Është anëtar i disa Klubeve e Organizatave letrare austriake e ndërkombëtare. Aktiviteti i tij letrar është i pasur, ka lexuar në mbi 350 orë letrare e artistike në shumë vende. Peter P. Wiplinger është njëri nga aktivët në P.E.N Clubin Ndërkombëtare dhe P.E.N Clubit në Austri. Është shpërblyer me shumë dekorata e mirënjohje ndër të cilat vitin 2015 "Dekorata e Lartë e Nderit për Merita ndaj Republikën e Austrisë". Ka një qëndrim parimor të ashpër ndaj politikave diskriminuese në mbrojtje të të drejtave të njeriut si është anëtar i disa organizatave. Krijimtaria e tij e gjithanshme flet për një personalitet me vlera të mirëfillta jo vetëm tek lexuesi austriak por dhe më gjerë. Disa vite e mbështetë aktivitetin letrar të Lidhjes së Shkrimtarëve e Krijuesve Shqiptarë "Aleksandër Moisiu" në Austri, ku është anëtar nderi. I kishte miq Dr.Ibrahim Rugovën dhe Ali Podrimën.

vjershën time. Ky qëndrim tërhoqi vëmendjen fillimisht jashtë, jo në Austri; sepse në këtë vend thënia mbi të vërtetën në disa dekada do bazohen sikur ishin viktimë të Nacionalizmit, e ngritur në shkallë të gënjeshtres kolektive duke u munduar të

mohohej pjesëmarrja në veprimet e tmerrshme të Nacionalizmit, shpesh të mahnitur nga bashkërendimi.

**Nacional: A mundeni të na rikujtoni diçka të veçantë nga njohja e juaj me Dr.Ibrahim Rugovën, filozof, shkenctar**

*dhe politika, dhe Ali Podrimen, poet?*

**Wiplinger:** Tek lidhja ime e hershme me shqiptarët. Dr. Ibrahim Rugoven dhe poetin Ali Podrimja i kam takuar në Konferencën e PEN-it në Slovenski PEN Centers në Bled që në vitin 1980. Konferenca e Bledit ishte një kthesë në kontaktet me kolegë nga shumë vende. Si vend i pa angazhuar në Paktin e Varshavës "shtet neutral", nën regjimin e Titos, ishte vend takimi shumë i përshtatshëm edhe për kolegë nga vendet tjera komuniste (shumica nën vëzhgim). Tek Rugova vëreja një përqendrim të brendshëm, manifestuar me një qetësi gjakftohësie tërheqëse. Lëvizjet e tij të kujdesshme e mbresëlënëse, zëri i tij i qetë, fjalët e ngadalta dhe pa lëkundje, por i sunduar nga një përqendrim i brendshëm. Ai lente përshtypje kryesisht njeri i ëmbël, por me një qëndrim të pa lëkundur dhe këmbëngulës në synimet e tij. Ishte shumë i sjellshëm, me shoqërim kolegial, por vërehej një dozë tërheqje, në kontakte një shkëlqim në distancë. Ai më dukej gati ndrojtur por kurrë i heshtur e i frikësuar. Ai duke disi i thjeshtë, por asnjëherë nga dobësia. Ai ishte intelektual, shkencëtar me relief filozofi, i cili në pyetjen e të drejtave të njeriut me relevancë i angazhuar politikisht, para se gjithash ndaj popullit të tij si në Kosovë, në Serbi, në Maqedoni, gjithashtu në ish Jugosllavi ku shtypeshin pakicat nacionale. Ali Podrimja, ishte, si e ndieja unë dikur dhe verifikoja sot, ishte me natyrën e tij e cila shkëlqente, krejt e kundërt me atë të Ibrahim Rugovës. Aliu ishte shumë njeri i hapur, plotësisht i përzemërt dhe gazmor. Ne gjetëm menjëherë simpati njëri ndaj tjetrit, ishim, "për Ti" dhe e turrnim njëri tjetrin nga emri. Për këtë flet dhe vjersha ime për te.

Ne u takuam edhe në Strugë, në "Mbrëmja poetike në Strugë", gjithashtu edhe në disa takime nga PEN- konferencat në vende tjera, dhe një herë në Vjenë. Ishte një kohë e kontakteve mes nesh, kjo ishte shumë e bukur dhe me vlerë për mua.

Me "Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë "Aleksandër Moisiu", tani disa kohë jami në bashkëpunim rreth librave të mia dhe tjera, veçan me kolegët Besim Xhelili dhe Anton Marku Unë i kam ftuar me kënaqësi në lexime letrare dhe vet kam marr pjesë në lexime me ftesë nga ata. Jam i autorizuar për lidhje marrëdhënies

shumëkulturore nga se jam shumë vjet i angazhuar në këtë drejtim. Jam po ashtu themelues i "Platformës për autor/e me gjuhë tjetër nga gjermanisht- gjuhë amtare në Austri". Kjo do mbijeton akoma.

**Nacional: Çka mund të presim në te ardhmen nga ju?**

**Wiplinger:** Sa i përket në pozicioni pritës ndaj meje, sidomos nga kolegët shqipfolës, unë mund të them: Unë do luftoj, sa të kem mundësi, për të vërtetën dhe për drejtësi, për interesat legjitime të të gjithë njerëzve dhe organizatave që jetojnë në demokraci, të vlerave për liri, barazi e solidaritet, drejtat e njeriut; unë do deklaro hem edhe publikisht për këto gjera. Gjithë këto gjera me vetëdijen që zëri i ndërgjegjes dhe arsyes të mund të kuptohet lehte; mirëpo, ajo e bën edhe më të nevojshme mesazhin e saj.

**Nacional: Cili është mesazhi juaj për lexuesit/et tanë?**

**Wiplinger:** Vetëm që të them edhe disa fjalë rreth pyetjes për të ardhmen time letrare dhe rreth "mesazhit" tim: Unë punoj ende me shumë kënaqësi dhe intensitet - edhe pse tani i kam 78 vjet dhe sigurisht jam shumë i moshuar; unë shpresoj, që kjo do vazhdojë të jetë kështu. Unë jam një poet me fantazi, mirëpo jam edhe një njeri pa iluzione, i prekur nga realiteti. Mirëpo unë mendoj që ende ka mundësi për një të ardhme pozitive për njerëzit. Por, për të pasur vërtet mundësi për një jetë njerëzore për të gjithë njerëzit, njeriu duhet të behet njeri më së pari. Sisteme dhe bartës të sistemit që janë jo-njerëzor duhet të munden e tejkalohehen. Kjo është një rrugë që pothuajse nuk është e mundur, mirëpo në të njëjtën kohë është mundësia e vetme që njerëzit të jetojnë një jetë të njerëzishme dhe që ky planet mos të shkatërrohet nga vet banuesit e tij. Edhe pse kjo mundësi është shumë e vështirë të realizohet, ne duhet të besojmë edhe me shume, te angazhohemi edhe me shume, te veprojmë me shumë në këtë drejtim, të besojmë në këtë mundësi. Ne duhet të besojmë në "Principin e Shpresës" (filozofi gjerman, Eduard Bloch), dhe ta mbrojmë atë. Ne nuk duhet të heqim dorë kurrë nga "Principi i Shpresës", sepse për ndryshe do heqim dorë nga vetvetja. Rezignacioni nuk është opsion për të ardhmen, sepse nuk është kurrësi as për jetën.

## Hapet një pikë e grumbullimit të qumështit në Malishevë

**MALISHEVË, 14 QERSHOR (ER)** - Në fshatin Carrallukë të Komunës së Malishevës është hapur të premten pika e grumbullimit të qumështit. Hapja e kësaj pike të grumbullimit të qumështit është vlerësuar të jetë shumë e rëndësishme për të gjithë fermerët e kësaj komune, pasi një pikë e tillë moderne u mundëson fermerëve që ta bëjnë dorëzimin e qumështit më afër fermave të tyre.

Në hapjen e kësaj pike grumbulluese kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori

Komunal i Bujqësisë, Murat Hoxha, të cilët e kanë uruar pronarin Sami Krasniqi për hapjen e pikës dhe vazhdimin e traditës së tij për grumbullimin e qumështit. "Hapja e kësaj pike grumbullimi nuk është thjesht një biznes për pronarin, por një lehtësim edhe për të gjithë fermerët të cilët kanë ferma apo mbajnë lopë dhe detyrimisht duhet ta dorëzojnë qumështin. Po ashtu, kjo është një mundësi më shumë për konsumimin e produkteve vendore, pasi prodhimi dhe produktet që ju merrni do të konsumohen në tregun vendor",

ka thënë Begaj.

Begaj e Hoxha janë takuar edhe me fermerët që dorëzojnë qumështin në këtë pikë dhe janë njoftuar me problemet që ata kanë, sidomos me çmimet e ulëta, ashtu sikur janë në tërë vendin. Për këtë problematikë, kryetari Begaj ka thënë se është i njoftuar me këtë dhe do të bëjë të pamundurën për subvencionimin e qumështit, por edhe për prodhimet dhe produktet e tjera vendore. Hapja e kësaj pike grumbulluese të qumështit është mundësuar nga Ministria e Bujqësisë.



## Në spitalin rajonal të Pejës vdes një i burgosur

**PRISHTINË, 14 QERSHOR (ER)** - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se të premten në spitalin rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri me inicialet I. A., i lindur në vitin 1992. I burgosuri, me rekomandim të mjekut të Q. K. Dubravë, është dërguar të premten me urgjencë në spitalin rajonal të Pejës rreth orës 10:10 ku, pavarësisht prej ofrimit të

ndihmës mjekësore, ka ndërruar jetë. I. A. ishte shtetas i Republikës së Shqipërisë. Ai akuzohej për veprën penale: "Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve". I njëjti po vuante dënimin në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Lidhur me shkaqet e vdekjes, trupi i pajetë do të dërgohet për obduksion.



## Në Prizren diskutohet rreth projektit për krijimin e kushteve të shëndetshme urbane

**Prizren, 14 qershor (ER)** - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se në objektin e Administratës Komunale është mbajtur takimi i grupit punues i projektit "Mbështetje për Prizrenin e Qëndrueshëm - Iniciativa NAMA Urbane (Nationally Appropriate Mitigation Actions)", i cili është realizuar në bashkëpunim në mes të kësaj komune dhe UNDP-së.

Ky projekt ka për qëllim përgatitjen e qytetit të Prizrenit për reduktimin e emetimeve të përgjithshme të gazrave serrë (GHG), kontribuimin për krijimin e kushteve të shëndetshme të jetesës urbane dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Pjesë e këtij takimi ka qenë drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Prizren, Levent Kasëmi, përfaqësues komunalë, ata të

UNDP-së, të organizatave joqeveritare, përfaqësues të Universitetit të Prizrenit, si dhe pjesëmarrës të tjerë të projektit.

Gjatë këtij takimi është prezantuar qëllimi i projektit nga Xhevrije Berisha, menaxhere e projektit nga UNDP-ja, ndërsa palët kanë parashtruar pyetje dhe janë informuar për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me projektin.

## Lladrovci ndan mirënjohje për reporterin britanik të luftës dhe ushtaraken kanadeze

**DRENAS, 14 QERSHOR (ER)** - Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të çlirimit të Komunës së Drenasit, kryetari i kësaj komune, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim gazetarin britanik Vaughan Smith dhe ushtaraken kanadeze Sophie Boisvert Levesque, të cilëve u ka ndarë mirënjohje për kontributin e tyre për Kosovën.

Kryetari Lladrovci gjatë takimit ka vlerësuar lart kontributin e tyre dhe ka falënderuar për punën e palodhshme për ta sensibilizuar opinionin ndërkombëtar për popullin e Kosovës. "Ndihem shumë mirënjohjes që në këtë ditë, sot në mesin tonë është gazetari, fotografi dhe dokumentuesi i parë i të vërtetës së krimeve serbe në Kosovë, dëshmitari i parë i

masakrave dhe tokës së djegur nga njësitet ushtarake serbe në Drenicë, në Prekaz, gazetari nga Mbretëria e Bashkuar, z. Vaughan Smith. Po ashtu, jemi të nderuar të gjithë qytetarët e Drenasit që në mesin tonë është ish-ushtarakja e Kanadasë, veteranja e ushtrisë kanadeze, Sophie Levesque Boisvert, ushtarja e cila nëpërmjet trupave të NATO-s u kujdes edhe për fëmijët e Drenasit. Kurrë nuk do ta harrojmë kontributin tuaj", ka thënë i Lladrovci.

Gazetari Smith dhe ish-ushtarakja kanadeze, Levesque, kanë qenë edhe mysafirë nderi në seancën solemne të Kuvendit Komunal të Drenasit, i cili është mbajtur për nder të 20-vjetorit të Ditës së Çlirimit të Komunës së Drenasit.



## BE: Rusia u përpoq të ndërhyjë në zgjedhjet evropiane

BRUKSEL, 14 QERSHOR - Bashkimi Evropian tha se ka mbledhur dëshmi për aktivitete "të vazhdueshme dhe të qëndrueshme" të dezinformimit nga Rusia, me synim që të ndikonte në rezultatet e zgjedhjeve të majit për Parlamentin Evropian. Raporti i Komisionit Evropian thotë se "burimet ruse" u përpoqën të kufizojnë pjesëmarrjen e votuesve dhe të ndikojnë në preferencat e tyre.

Raporti nuk shpjegon se çfarë nënkupton me "burimet ruse". Ai pason paralajmërimet qysh para zgjedhjeve të Brukselit për vendet e BE-së dhe kompanitë e medieve sociale, që të jenë syhapur përballë lajmeve të mundshme të rene nga Rusia. Aktivitetet malinje - të vërejtura në raportin e 14 qershorit - variojnë nga sfidimi i legjitimitetit demokratik të BE-së deri te shfrytëzimi i debateve përçarëse mbi

çështje si migracioni. Komisioni Evropian tha se përpjekjet e tij për të luftuar lajmet e rene kanë ndihmuar në reduktimin e sasisë së dezinformatave që shfaqen në internet, por ai shtoi se duhet bërë më shumë. "Taktikat e përdorura nga aktorët e brendshëm dhe të jashtëm, në veçanti të lidhura me burimet ruse, po zhvillohen shpejt, njësoj si edhe masat që marrin shtetet dhe platformat online", tha Komisioni Evropian.



# Trumpi përballë reagimeve të ashpra për komentet për ndërhyrjen e huaj

Presidenti Donald Trump befasoi edhe disa republikanë me deklaratën e tij se do të pranonte informacion nga një qeveri e huaj për ta sabotuar rivalin e tij në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020

UASHINGTON, 14 QERSHOR - Në Shtetet e Bashkuara demokratët reagan menjëherë ndaj pohimit të presidentit Donald Trump se nuk ka asgjë të keqe të dëgjosh informacion për kundërshtarët politikë, edhe nëse ai vjen nga një vend i huaj. Trumpi befasoi edhe disa republikanë me deklaratën e tij se do të pranonte informacion nga një qeveri e huaj për ta sabotuar rivalin e tij në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020. Në një intervistë me "ABC News", presidenti Trump tha se nëse do t'i bëhej një ofertë e tillë, ai do ta merrte në konsideratë. Por në një intervistë të premtën, Trumpi u duk sikur u tërhoq nga komentet e tij kur tha se nëse mendonte se diçka ishte e pasaktë në këtë informacion, ai do t'i njoftonte pa diskutim organet e rendit. Kritikët e shohin komentin fillestar të presidentit Trump si një ftesë ndaj qeverive të huaja për ta vazhduar ndërhyrjen në sistemin demokratik amerikan në një kohë kur ligjvënësit po përpunonin të parandalonin një përsëritje të ndërhyrjes ruse në zgjedhjet e vitit 2016, ka njoftuar voa.

Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi tha të enjten se Trumpi edhe një

herë tregoi se nuk dallon dot të drejtën nga e gabuara. "Të gjithë duhet të jenë thellësisht të indinjuar nga ajo që tha presidenti. Thellësisht të indinjuar. Por ai gjithmonë bën deklaratatë tilla indinjuese. Kjo e fundit është aq joetike dhe ai as nuk e kupton", tha ajo. Komentet e transmetuara në televizione e kanë bërë të vështirë për kolegët republikanë ta mbrojnë presidentin. "E kam parë presidentin t'u bëjë rezistencë entiteteve të huaja dhe ai nuk do të lejonte vende të huaja të ndërhyjnë në zgjedhjet tona", tha Kevin McCarthy, udhëheqës i pakicës republikane në Dhomën e Përfaqësuesve. Senatori Mitt Romney nga Utah, një republikan që ka kandiduar dy herë për president, ishte i prerë. "Ka shumë gjasa që është e paligjshme. Por nëse nuk është, duhet të jetë e paligjshme. Por ne nuk duhet absolutisht të lejojmë qeveritë e huaja të përpunonin të ndërhyjnë në zgjedhjet tona. Kjo do të binte ndesh me frymën e demokracisë", tha ai. Anëtarët e Kongresit kanë dënuar njëzëri ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara dhe shumë prej tyre po kërkojnë një legjislacion për sigurinë e votës. Por këto përpjekje janë bllokuar



nga udhëheqësi republikan i shumicës në senat, Mitch McConnell, një përkrasës i vendosur i Trumpit. Chuck Schumer, kreu i demokratëve në Senat, foli për këtë temë të enjten. "Ne kemi disa projekt-ligje dypalëshe që kanë ngecur në Senat. Madje kemi një

projekt-ligj që është propozuar nga nënkryetari demokrat i Komisionit të Zbulimit, sipas së cilit do të ishte detyrim ligjor i fushatës për të raportuar tek FBI-ja nëse një fuqi e huaj ofron ndihmë. Shumë e thjeshtë: Nëse një fuqi e huaj i ofron ndihmë fushatës suaj, ia raporton FBI-së",

tha ai. Analistët thonë se projektligjet kanë shumë gjasa që të ngecin për shkak të mbështetjes së palëkundur të votuesve republikanë për presidentin Trump. Ligjvënësit republikanë që sfidojnë Trumpin hapur, do të vinin në rrezik rizgjedhjen e tyre.

## Turqia thotë se do t'iu hakmerret sanksioneve të mundshme të ShBA-së

ANKARA, 14 QERSHOR - Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, tha se Ankaraja do të hakmerret kundër sanksioneve të mundshme nga Uashingtoni. ShBA-ja e ka kërcënuar Turqinë me sanksione për shkak të marrëveshjes me Moskën për blerjen e sistemit raketor rus S-400. Në komentet për agjencinë turke të lajmeve Anadolu, Cavusoglu tha se Turqia ka të drejtë të vendosë për

blerjet e saj si "një shtet i pavarur dhe i lirë". Marrëveshja e Turqisë me Rusinë i ka dëmtuar marrëdhëniet e saj me ShBA-në. ShBA-ja thotë se raketat S-400 janë kërcënim për avionët e saj luftarakë F-35. Kathryn Wheelbarger, ushtruese e detyrës së ndihmëssekretares amerikane të Mbrojtjes, tha muajin e kaluar se pasojat do të jenë "shkatërruese" për bashkëpunimin

e Turqisë me NATO-n, nëse Ankaraja vazhdon me planet e saj për blerjen e sistemit raketor rus. Wheelbarger tha se blerja do ta dëmtonte aftësinë e Turqisë për të punuar me aleancën perëndimore dhe do ta detyronte Uashingtonin të vendoste sanksione ndaj Ankarasë. Cavusoglu tha se Turqia do të përgjigjet me "kundër hap" nëse Uashingtoni i vë sanksione.







# Deti na bën mirë, na bën të bukur dhe më të lumtur... e thotë edhe shkencë



**A**jri, dielli dhe ngjyra blu janë një kurë e vërtetë për trupin dhe shpirtin. E kemi përjetuar të gjithë, sidomos nëse jetojmë në një qytet të madh: mjafton të kaloni një fundjavë të shkurtër në det për të shkuar në shtëpi me një ngjyrë të bukur, një pamje më të shëndetshme dhe më dinjitoze dhe një humor të relaksuar dhe të ngritur. Nuk është vetëm pushimi: drita e diellit ka efekte pozitive në humor dhe deti është një burim i pamasë i mirëqenies dhe i virtyteve pozitive. Të lumtur në det – Një libër i botuar disa vjet më parë, me titull “Blue Mind Mente e acqua” nga Wallace J. Nichols, mbledhi rezultatet e studimeve të shumta shkencore të kryera gjatë një dekade, sipas të cilave afërsia me ujin favorizon lirimimin në tru të dopaminës, serotoninës dhe oksitocinës, që konsiderohen në përgjithësi si neurotransmetues të lumturisë dhe mirëqenies. Uji na sjell përsëri në gjendjen tonë natyrore, siç ishim në barkun e nënës: edhe thjesht duke vëzhguar një panoramë të detit

në fotografi nxit relaksim në një nivel nënndërgjegjës; duke qenë afër ujit (dhe madje edhe më mirë të zhytur në të) përmirëson hapësirën e vëmendjes; Më në fund, ngjyra blu gjeneron qetësi dhe lehtësim dhe konsiderohet nga shumica e njerëzve si ngjyra e tyre e preferuar. Deti rigjeneron – Një notim i këndshëm mes valëve të detit, një shëtitje në bregdet ose uji që arrin këmbët, ose thjesht duke u zhytur deri në bel duke lënë veten të masazhohet nga lëvizja e valëve: këto janë gjërat që bëjmë zakonisht në një ditë në plazh, por në praktikë ne kemi rikthyer të gjitha hapat e një seance në palestër dhe në qendrën Wellness: sport, aktivitet me ndikim të ulët, hidromasazh. Plus mundësinë për të shijuar përfitimet e kripës së detit të thithur nga lëkura jonë. Me pak fjalë, plazhi mund të bëhet një spa fantastike në ajër të hapur. Drita e diellit – Rrezet e diellit, nëse absorbohen me kujdes të duhur, janë të domosdoshme për shëndetin tonë të mirë. Ato janë thelbësore për thithjen

e vitaminës D, thelbësore për metabolizmin e kalciumit dhe për këtë arsye për kalcifikimin e eshtrave dhe dhëmbëve, për të parandaluar rakitët dhe sëmundjet e caktuara të lëkurës. Duke parë që thithja e rrezatimit diellor për sintezën e vitaminës D ndodh përmes lëkurës, ideale është që të ekspozojmë lëkurën e zbuluar, të paktën në krahë dhe këmbë për rreth tridhjetë minuta në ditë. Kjo formë thelbësore e helioterapisë mund të praktikohet edhe në qytet: gjëja më e rëndësishme është të ekspozojmë veten në diell gradualisht dhe duke përdorur një filtër të mirë mbrojtës, përshatur me fototipin tonë, duke i mbrojtur sytë me lentet diellore të përshtatshme. Është mirë të shmangen orët qendrore të ditës kur rrezet janë më të nxehta. Rrezet e diellit gjithashtu stimulojnë prodhimin e hormoneve të mirë të humorit, kështu që kalimi i kohës jashtë është një balsam i vërtetë kundër stresit dhe ankthit. Ajri i detit – Rajonet bregdetare gëzojnë një klimë veçanërisht të shëndetshme:

nivelet e ndotjes janë zakonisht më të ulëta dhe ajri është i ngarkuar me kripërat minerale të transportuara nga valët, në veçanti klorid natriumi, jodi, kalcium, magnez, kalium dhe brom.

Sistemi i frymëmarrjes përfiton nga e gjithë kjo, veçanërisht nëse vuajmë nga alergjitë dhe astma: për të shijuar të gjitha avantazhet, ideale është të ecësh në plazh ose në shëtitore, sidomos kur fryn erë. Banjat e kripura – Falë përqendrimit të kripërave të detit, një notim i këndshëm ose thjesht qëndrimi afër ujit ku është i ulët është një ilaç i shkëlqyeshëm natyror për të luftuar disa forma të inflamacionit dhe për të stimuluar kullimin limfatik. Me pak fjalë, uji i kripur na ndihmon të deflatojmë dhe përmirësojmë mikrocirkulacionin lokal, duke luftuar dehidratimin dhe celulitin. Ecja në ujë kombinon efektin kullues të ushtruar nga kripa me veprimin e një masazhi të kryer në trup nga presioni i ujit në lëvizje. Tiroidja – Ajri i detit është veçanërisht i pasur me jod dhe

kjo nxit mirëqenien e atyre që kanë tiroide (hipotiroidizëm). Përkundrazi, ata që vuajnë nga hipertiroidizmi, çrregullimi i kundërt, që është, me një tiroide që funksionon me shumë vështirësi, do të bënin mirë të zgjidhnin një vend me sasi të ulët të jodit në ajër, për shembull në mal, për pushime. Për ata që rrinë në shtëpi – Disa avantazhe të ujit të detit mund të transportohen në shtëpinë tuaj, në sajë të produkteve të thalasotheapye dhe shtojcave të bazuar në alga deti. Shumë tregje përmbajnë kripërat e banjës, duke filluar nga ato të Detit të Vdekur, të cilat mund t’i përdorim për banjot freskuese dhe relaksuese në vaskën tonë shtëpiake; ose ne mund të përkëdhelim veten me një pastues të bazuar në kripë deti. Nëse ndjehemi pak më poshtë dhe kemi nevojë për një goditje të energjisë së re, mund të provojmë një shtojcë të bazuar në algat spiruline, të pasura me vitamina dhe të shkëlqyera për të luftuar stresin.

E rrallë

## Qeni i zgjuar thotë 'Hello'

Një video shumë gazmore tregon një qen që i thotë 'hello' pronares së tij. George, 6-vjeç, filloi ta thoshte fjalën përshëndetëse dy vjet më parë. Pronarja Kathryn Schofield ka bërë me dije se ia përsëriti disa herë derisa qeni e mësoi ta thoshte në mënyrë të përsosur. Në videon e shpërndarë në rrjetet sociale shihet George në prehrin e 36-vjeçares.



Kur Kathryn i thotë 'hello', qeni i përgjigjet 'hello'.

FOTO E DITES



Një aeroplan i vogël rrëzohet në një autostradë të Portugalisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Mijëra paund 'fluturojnë' nga bankomati

Një person në Londër u afrua para një bankomati për të tërhequr të holla, por nuk pati nevojë që ta fuste kartelën për ta kryer këtë shërbim pasi ATM-ja e bitconit i lëshoi atij kartëmonedha 20 paundëshe. Për ta shmangur marrjen e kartëmonedhave nga kalimtarët, policët rrethuan ATM-në, ndërsa klienti u përpoq t'i mblidhte paratë. Kompania e ATM-së ka njoftuar se incidenti



ndodhi për shkak se shumica e tërhequr ishte shumë e lartë.

## BARSOLETA E DITËS



Një vajzë, teksa po kalonte rrugën me një qen, e ndal dhe e pyet një djalë:  
 - Ku po shkon me atë dhi?  
 - Nuk është dhi, po qen, o injorant!  
 - S'të pyeta ty, po qenin, oj injorante!




### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

### "DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.  
 Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

### "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.  
 Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

### "EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.  
 Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

### "THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.


Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Sot do të bëni dhurata për njerëzit e dashur ose për kolegët. Është dita kur ndiheni mjaft mirë dhe doni ta përçoni këtë pozitivitet.</p>	 <p><b>DEMI</b> Karriera është ajo që ju shqetëson sot dhe e keni primare në ditën tuaj. Disa lëvizje në ambientin e punës kanë rritur ambiciet tuaja personale.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot jeni me fat si në lojë ashtu edhe në dashuri. Mund ta provoni fatin pa pasur merakun nëse do të fitoni ose jo. Yjet janë në anën tuaj.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Do të dëgjoni xhelozitë e partnerit përgjatë gjithë ditës sot. Një person i caktuar që ka ridal nga e kaluara, ka krijuar problem në lidhjen tuaj.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot jeni si koha, të plogësht dhe disi gri. Nuk ju pëlqen të lëvizni dhe të kryeni asnjë aktivitet. Ju ka pllakosur gjendja indiferente dhe rutina.</p>	 <p><b>VIRGJËRISHA</b> Ju pëlqen të lexoni në këtë periudhë dhe po i kushtoni shumë kohë blerjes së librave dhe këshillave për tituj interesantë.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Indiferenca është arma më e mirë me disa persona të caktuar. Kështu nuk do të mund t'ju bezdisin dhe shqetësojnë me fjalët e tyre.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Edhe pse po mundoheni të tregoheni autoritare në një ambient të caktuar, nuk jeni tipat e duhur. Do t'i mblidhni të gjithë për një gotë verë më pas.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Ka persona që ikin dhe ka persona të rinj që hyjnë në jetën tuaj. Raportet njerëzore janë të ndërtuara kështu dhe s'mund t'i shpëtoni as ju.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot jeni në harmoni të plotë me partnerin dhe çdo dëshirë e juaja do të bëhet realitet. Kishit kohë që nuk ishit ndjerë kështu.</p>	 <p><b>UJORI</b> Një takim i rastësishëm sot do të kthehet në një miqësi të mirë pas pak kohësh. Do ta kujtoni me nostalgji këtë çast më vonë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot e rëndësishme është ta kapni thelbin e gjërave pa u hapur shumë nëpër detaje që mund t'ju a ç'organizojnë ditën.</p>

## Justin Bieber i sfidon Tom Cruise



Justin Bieber i habiti fansat me sfidën e çuditshme që lëshoi në internet ndaj aktorit Tom Cruise, ku këngëtari kanadez e ftonte yllin hollivudian të përballëj me të në ring. Mesazhi i Bieberit në "Twitter" u përhap me shpejtësi

rrufeje, duke befasuar adhuruesit e yllit të popit, që e konsideruan një provokim të hapur. Por këngëtari nxitoi ta sqaronte vetë situatën. Ai u shpjegoi paparacëve të uebsajtit të famshëm "TMZ" se bëhet fjalë për një shaka.

## Selena Gomez pritët ta publikojë albumin e ri



Këngëtarja e njohur Selena Gomez ka bërë me dije se është në përfundim të albumit më të ri. Gomez kështu tha në një intervistë në emisionin "The

Tonight Show". Ajo ka theksuar se tek pas katër vjetëve është bërë gati të publikojë këtë album. "Unë jam gati në përfundim të albumit", ka thënë ajo.



## Cardi B më në fund heq dorë nga operacionet plastike

Cardi B e ka kryer me operacione plastike. Ajo përmes një postimi në llogarinë e saj në "Instagram" ka bërë me dije se nuk do të shkojë më për

të hyrë në thikë. Cardi ka postuar një fotografi të efekteve anësore që shkaktojnë operacionet plastike dhe për këtë tha se do të kujdeset për shëndetin.

## "Spice Girls", së shpejti të animuara



Në turneun e fundit nuk u mblodhën dot të gjitha, sepse mungoi Victoria Beckham, por këtë do ta bëjnë për një film vizatimor që i kushtohet pikërisht atyre:

Filmi për "Spice Girls" duhet të dalë në kinematë botërore në vitin 2020, i pasuruar edhe me këngë të reja të pesëseshes që bëri bujë të madhe nga fundi i viteve '90-ta.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

QENDRA SPORTIVE  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045 82 82 82

# Stadiumi kombëtar, projekti më i madh kapital në historinë e vendit

Stadiumi kombëtar, i cili do të ndërtohet afër aeroportit "Adem Jashari", është projektuar në bazë të kriterëve dhe standardeve të UEFA-s dhe të FIFA-s. Ky stadium do t'i ketë mbi 30 000 ulëse dhe do të jetë i përgatitur edhe për lojëra ndërkombëtare. Gjithashtu, stadiumi do të ketë një kompleks madhor i cili përfshinë fusha ndihmëse, konvikt për sportistët, hotel dhe parking të mjaftueshëm



## "Epoka e re"

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë të premtën në prezantimin e stadiumit kombëtar të Kosovës që u bë në ambientet e Muzeut të Kosovës. Pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, përfaqësues të shumtë të institucioneve të shtetit dhe të sportit si dhe anëtarë të familjes Vokri. Me këtë rast, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se prezantimi i stadiumit kombëtar është një ditë e veçantë, duke e cilësuar këtë

projekt kapital si më i madhi sa iu përket investimeve në historinë e vendit tonë. Ai ka bërë me dije se ky stadium do të ndërtohet afër aeroportit "Adem Jashari". "Është në mes të komunave të mesit të Kosovës, afër Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës dhe e lidh tërë territorin e Kosovës përmes autostradës. Çështja e lokacionit ka qenë vendim i drejtë dhe tashmë ka mbetur një etapë tjetër, ajo e ndërtimit", ka thënë Gashi. Në këtë prezantim u theksua se stadiumi kombëtar është projektuar në bazë të kriterëve dhe standardeve të UEFA-s dhe FIFA-s. Kapaciteti i tij arrin t'i ketë mbi 30 000 ulëse dhe do të jetë i përgatitur edhe për lojëra ndërkombëtare.

Gjithashtu, stadiumi do të ketë një kompleks madhor i cili përfshinë fusha ndihmëse, konvikt për sportistët, hotel dhe parking të mjaftueshëm. Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Kosova duhet ta ketë stadiumin më të bukur në Ballkan dhe ky duhet të ndërtohet. Ndërsa kryetari i Federatës, Agim Ademi, shpreh falënderime për Ministrinë e Kulturës dhe Qeverinë e Kosovës për punën që po bëjnë për sportin, duke përmendur fillimin e renovimeve të të gjitha stadiumeve, projektin me 12 fusha sintetike dhe tashmë edhe stadiumin kombëtar të cilin ai e cilësoi si kupola e infrastrukturës së futbollit.

## SHKURT

### UEFA heton Bullgarinë për sjellje raciste kundër Kosovës

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Komisioni Disiplinor i UEFA-s ka hapur rast kundër Bullgarisë për sjelljet raciste të tifozëve në përballjen ndaj Kosovës, në ndeshjen e vlefshme për eliminatorët për Euro 2020 në Grupin A. Sjelljet aspak të hijshme të tifozëve për përballjen e humbur ndaj Kosovës kanë bërë që UEFA të hapë një procedim disiplinor. Qeveria e Futbollit kontinental ka angazhuar strukturat e saj të etikës për koret raciste dhe parullat e hedhura në stadiumin Vasil Levski të Sofjes. UEFA ka bërë me dije se rasti do të trajtohet më 18 korrik dhe ka përfshirë shkeljen e nenit 14 që disiplinon sjelljet raciste.



Në raste të tilla analoge gjoba ka qenë e padiskutueshme, por në jo pak federata është aplikuar dhe dënimi i fushës. Në shumë momente para dhe gjatë sfidës, tifozët bullgarë ishin autorë të koreve antishqiptare në mbremjen ku Kosova triumfoi në sekondat e fundit me rezultat 2:3. Golat për dardanët në fitoren historike, të parën në kualifikuese për Kampionat Evropian, i shënuan Milot Rashica, Vedat Muriqi dhe Elbasan Rashani.

### Përurohet fusha ndihmëse në Shkugëz të Gjakovës

GJAKOVË, 14 QERSHOR (ER) - Në fshatin Shkugëz të Gjakovës është inauguruar Fusha Sintetike e Futbollit, projekt i financuar nga



Ministria Kulturës, Rinisë dhe Sportit bashkë me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe Komunën e Gjakovës. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili ishte i pranishëm në këtë inaugurim ka thënë se bashkëpunimi i mirë mes MKRS-së, FFK-së dhe Komunës ka bërë të mundur realizimin e këtij projekti. Ministri Gashi po ashtu mori pjesë edhe në themelimin e Akademisë së Futbollit "Naim Kryeziu, duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme dhe të nevojshme edhe themelimin e kësaj akademie. "Realizimi i projekteve të tilla po bëhet në vazhdim dhe punëve tona për përmirësimin e infrastrukturës sportive. Sportistët tanë çdo ditë e më shumë po arrijnë rezultate kulminante edhe jashtë vendit kështu që edhe puna jonë për plotësimin e kushteve për të rinjtë e vendit tonë dhe ndërtimin e fushave sintetike nuk do të ndalet me kaq", ka thënë ministri Gashi.

## Francesco Totti pritet të largohet nga Roma

ROMË, 14 QERSHOR - Francesco Totti, legjenda e Romës dhe futbollit italian, ka tronditur publikun lokal në bazë të titujve të mediave italiane. Ish-lojtar i është adresuar fansave

dhe opinionit publik përmes llogarisë zyrtare në "Twitter", duke thënë se shumë shpejt do të flasë rreth klubit romak. "Në këtë kohë po shkruhet se goja kam dhënë

disa mendime dhe kam bërë disa përzgjedhje. Së shpejti do ta jap opinionin tim personal", ka shkruar italiani në rrjetet sociale. "Gazzetta dello Sport", mediumi

më i respektuar sportiv italian, në bazë të kësaj, argumenton se kjo është dëshmi se si adhurohet "Il Capitano" dhe se është shumë afër largimit nga klubi i jetës.







Shoqëria Humanitare Bëmbëse e Kosovës "Nëna Tereza"  
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"  
Humanitarne Dobrotvorno Udruženje Kosova "Majka Tereza"  
10-000 Prishtinë Rr. ULPIANA U1/1 po. Tel: 060381 38 542 864. Fax: 542 869,  
Web site: www.motherteresasociety.org e-mail: mterezaj@yahoo.com

## NJOFTIM PËR KONTRATË

### Sherbime

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 14/06/2019

Nr i Prokurimit	MIN-Trajnim	002	2019	221
-----------------	-------------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në Gjuhët:

Shqip

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

#### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: SHHBK "Nëna Tereza"		
Adresa Postare Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000	Vendi: Prishtinë
Personi kontaktues: Zef Shala		Telefoni: 038-542-864
Email: zefshala@hotmail.com		Faksi: 038-542-869
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		www.motherteresasociety.org

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

#### II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Sherbime Trajnimi në Ndërmarrësi (punësim dhe vetpunësim) për 100 pjesmarrës
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhmi vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

	Shërbime
	Vendi kryesor i realizimit E tere Kosova sipas kërkesës së A.K.
II.1.3) Njoftimi përshinë Krijimin e kontratës publike kornizë	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë Nukë aplikohet	
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Sherbime trajnimit ne ndermarrësi (punësim dhe vetepunësim) per 100 perfitues te cilet paraprakisht jane trajnuar ne Qendrat per aftësim profesional ne profesione te ndryshme, si dhe janë paisur me pajisje per punë konformë profesioneve te tyre pas qertifikimit	
II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 93.000.000.000-03 <input type="checkbox"/>	
II.1.7) Variantet pranohen	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Ndarja në Pjesë	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve (nëse aplikohet): nukë aplikohet	
II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: Rreth 30.000.00 Euro	

#### II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm nukë aplikohet

#### II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj dy muaj apo 60 ditë (nga nënshkrimi i kontratës)

apo

Fillimi 03/07/2019

Përfundimi 03/09/2019

#### NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

##### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit 3 % e vlerës së kontratës

Formulari standard: "Njoftimi për Kontratë"

2

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës Jo

#### III.2) KUSHTET PËR P.JESËMARRJE

##### III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Certifikata e regjistrimit
2. Certifikata e nr.fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dokumentet adekuate te kopiuara

##### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- 1.Licensa adekuate-Certifikata
- 2.Lista e te punësuarve si staf profesional dhe administrativ

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dokumentet adekuate

##### III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. Vertetimi tatimor nga ATK-ja vetem per kompanine fituese
- 2.Transaksioni bankar per vitin 2018

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dokumentet adekuate

##### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Lista e Inventarit te punes te Organizates
- 2.Lista e mjeteve themelore-Kerreve

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dokumentet adekuate-Librezat e qarkullimit te kerreve

#### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar Jo

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve Jo

#### NENI IV: PROCEDURA

##### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

###### IV.1.1) Lloji i procedurës

E hapur

##### IV.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

##### IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

Formulari standard: "Njoftimi për Kontratë"

3

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë Jo

##### IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit: data 19/06/2019

Dokumentet me pages Jo

##### IV.3.3) Afati i fundit për pranimit të tenderëve:

data 24/06/2019 koha12.00 vendi Prishtinë Rruga Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1

IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:  jo

##### IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Jo

IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: data: 28/06/2019 ditë 30 apo muaj nje

##### IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 24/06/2019 koha12.30 vendi Prishtinë rruga Mujë Krasniqi p.n. Ulpiana U1/1

#### NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

##### V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

##### V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Financave- Ministarstvo za Finansija- Ministry of Finance**

Ministria e Financave zgjatë:

### VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Vazhdohet për 7 ditë kalendarike afati i konkursit të shpallur nga data 30/05/ 2019 deri me datë 13/06/ 2019, për pozitën e lirë:

- Analist i lartë standardeve të Auditimit (1 pozitë) -nr. Referencës, 17/2019/ DRF/MF;

Afati i konkurimit vazhdohet nga data 15 qershor 2019 deri më datën 21 qershor 2019 deri në orën 16.00.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Sheshi Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në web-faqen <https://mf.rks-gov.net/>. Kërkesat për punësim dorëzohen në zyrën e burimeve njerëzore nr. N-1207 kati XII, ndërtesa e Qeverisë, ose përmes postës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038-200-34.155.

Ministarstvo za finansije:

### PRODUŽAVA ROK KONKURSA

Produžava se za 7 kalendarskih dana rok konkursa objavljen dana 30/05/ 2019 do 13/06/ 2019, za slobodnu poziciju;

- Viši analitičar revizijskih standarda (1 pozicija)- br. Referencije, 17/2019/ DFI/MF;

Produžava se rok za konkurisanje od 15. juna 2019 do 21 juna 2019 do 16.00 časova.

Zahtevi za zapošlavanje i opis poslava mogu se dobiti na recepciji zgrade vlade Republike Kosova (ulica Majka Tereza bb). Obrazce za apliciranje možete preuzeti i sa veb-sajta <https://mf.rks-gov.net/>. Zahtevi za zapošlavanje predaju se u kancelariji ljudskih resursa br. N-1207 XII sprat, Zgarda Vlade, ili poštom.

Dodatne informacije možete dobiti preko telefona: 038-200-34-155.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit*  
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*  
*Ministry of Infrastructure and Transportation*

### ANULIM I KONKURISIT

Anulohet konkursi i jashtëm për pozitën, **Auditor/e i/e Brendshëm/me**, me numër të referencës RN00004933, i shpallur më 25.05.2019 deri 08.06.2019, për arsye të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve.

Nga aplikuesit për këte pozite kërkojmë mirëkuptim.

### ANULIRANJE KONKURSA

Anulira se konkurs za položaj **Unutrašni/ca Revizor**, br. reference RN00004933, objavljen 25.05.2019.god do 08.06.2019, razlog zbog nedovoljog broja kandidata

Molimo prijavljene kandidate za razumijevanje!

**Lumë's Details**  
**Estetik & Depilim**

044 900 978 | 045 681 898  
 Sallon Depilimi Lumë's Details  
 lumesdetails  
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Mirlinda Sopjani shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës SH.M.M. "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë me nr. 214. e lëshuar në vitin 2006.
- ▶ Endrit Hamza shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI IX shf "Avdyl Frasheri " Prizren
- ▶ Rahime Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dy Dëshmorët " Piranë
- ▶ Idriz Bytywi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dy Dëshmorët " Piranë
- ▶ Festim Salihu shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren
- ▶ Dr. Alban Hasani, Urolog nga Prizreni shpallë të pavlefshme certifikatën e Licencës së mjekut të përgjithshëm me nr. KO-04672-01.
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

# PA LIMIT MIN & SMS 3GB



# 4.99€

\*Pako përmban edhe 300 minuta me operatorë tjerë në Kosovë.



Pakot mujore të Ofertës më të mirë n'botë përmbajnë benefite të kombinuara si minuta PA LIMIT brenda rrjetit, minuta me operatorë tjerë, SMS PA LIMIT drejt të gjithë operatoreve dhe internet në mobil.

## IDEALE

MIN&SMS PA LIMIT  
+300 MIN  
DREJT OPERATORVE TJERË  
3GB

4.99€

## PLUS

MIN&SMS PA LIMIT  
+500 MIN  
DREJT OPERATORVE TJERË  
5GB

6.99€

## TOP

MIN&SMS PA LIMIT  
+700 MIN  
DREJT OPERATORVE TJERË  
10GB

12.99€

## FANTASTIK

MIN&SMS PA LIMIT  
+1000 MIN  
DREJT OPERATORVE TJERË  
20GB

17.99€

\*Pasi që shpenzoni minutat me operatorë tjerë, çmimi për minutë është vetëm 5 cent.

Balancin e benefiteve e kontrolloni duke thirrur \*123#

Vizitoni pikën më të afërt të IPKO-së për të marrë njëren nga këto pako.

WWW.IPKO.COM

